

PROF. DR. JORGJI BOLLANO

ARRITJET, VËSHTRËSITË, SFIDAT E RF DHE STRATEGJIA E KKK PËR TË ARDHMEN

Të nderuar pjesëmarrës në këtë sallë!

Konferenca e sotme, është e treta që KKK organizon në një periudhë tetë vjeçare të krijimit të vet. Dy të parat ishin me karakter shkencor, njëra në rang kombëtar dhe tjetra në rang ndërkombëtar. E sotmja është një Konferencë Jubilare në kuadrin e 100 Vjetorit të Pavarësisë së vendit, ku do të mbahen disa referime në të cilët do të trajtohen aspekte të ndryshme, të lidhura me kontabilitetin dhe zhvillimin e tij.

Në referimin tim do të përqëndrohem kryesisht në domosdoshmërinë e përsosjes së infrastrukturës ligjore dhe institucionale në fushën e kontabilitetit në këto dy dekadat e fundit dhe sidomos në përcaktimin e rrugëve që do të ndiqen për realizimin e strategjisë në të ardhmen, për ta bërë kontabilitetin sa më funksional e në përgjigje të kërkesave që ka sot shoqëria dhe ekonomia në veçanti, për ta bërë një busull që tregon se ku ndodhemi dhe ku do të arrijmë.

Shoqëria njerëzore në çdo fazë të zhvillimit të saj, ka patur nevojë për informacion për të gjitha fushat e veprimtarisë së saj, por sidomos për aktivitetin ekonomik. Këtë informacion më mirë se kushdo tjetër e siguron **KONTABILITETI**.

Kontabilitetit, në etapat e ndryshme të zhvillimit të tij, nga autorë të ndryshëm i janë dhënë përcaktime dhe kuptime të ndryshme. Sot me kontabilitet kuptojmë një sistem përmbledhës informacioni dhe komunikimi që përdoret për marrjen e vendimeve në përdorimin e burimeve ekonomike, i cili lejon kontrollin efektiv të përdorimit të këtyre burimeve si dhe vlerësimin e rezultateve të arritura nga aktiviteti ekonomik. Me këtë duhet të kuptojmë që një rëndësi të veçantë marrin pasqyrat financiare që përgatiten mbi bazën e kontabilitetit dhe u komunikohet të tretëve.

Në kohët moderne raportimi financiar merr një rëndësi shumë të madhe për faktin se shërben si “gjuhë e përbashkët” në hartimin e pasqyrave financiare të publikuara në vende të ndryshme të botës. Për informacionin tuaj, sot standardet ndërkombëtare të kontabilitetit në fuqi nga 41 të hartuara janë vetëm 29 dhe vijon procesi i filluar pas vitit 2000, për kalimin nga SNK në SNRF, të cilat kanë arritur deri në SNRF 13. Gjithashtu sjell në vëmendjen tuaj dhe faktin që Bordi i Londrës si jemi mësuar në këto vite ta quajmë, prej Korrikut 2010 është emërtuar Fondacioni i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

I kthehemi realitetit në vendin tonë. Ligji i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, nr.9228, datë 29.04.2004 u emërtua Ligji “ Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” duke kombinuar në këtë mënyrë traditën me modernen. Aktualisht në vendin tonë struktura e raportimit financiar është organizuar në tre nivele bazuar në ligjin e mësipërm.

- **Në nivelin e parë** përfshihen njësitë ekonomike të cilat zbatojnë SNRF-të. Këto janë njësi ekonomike të listuara dhe me interes publik (bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e sigurimeve dhe risigurimeve, fondet e letrave me vlerë) edhe kur ato nuk janë të listuara në një bursë zyrtare letrash me vlerë dhe njësitë e tjera ekonomike të mëdha, të palistuar kur ato kanë realizuar dy vitet e fundit njëkohësisht këto dy kritere:

A) të ardhurat vjetore mbi 1,250,000,000 lekë;

B) numrin mesatar vjetor të punonjësve mbi 100 persona.

- Në nivelin e dytë përfshihen njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme që zbatojnë 14 SKK, të hartuara këto në koherencë me SNK (SNRF).
- Në nivelin e tretë janë mikronjësitë të cilat bëjnë raportimin mbi bazën e SKK 15 “Mbi parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar nga mikronjësitë”.

Me këtë strukturë të raportimit financiar ne kemi arritur që të gjitha njësitë ekonomike të jenë objekt i rregullimit kontabël duke patur parasysh interesin për informacion kosto – përfitim dhe kapacitetet njerëzore. Shqipëria është një nga të paktat vende që ka implementuar standardet e kontabilitetit në këto tre nivele të cilën e konsiderojmë si një arritje madhore.

Për të arritur deri këtu KKK ka ndjekur këto rrugë:

Së pari, përshtatjen e kontabilitetit me ekonominë e tregut. Kjo u realizua me hartimin dhe miratimin e ligjit “Për kontabilitetin”, nr. 7661, datë 19.01.1993, plotësuar me hartimin e Planit Kontabël të Përgjithshëm, miratuar me VKM nr. 334, datë 09.07.1993. Këto dy dokumenta të rëndësishëm hodhën themelet e rregullimeve kontabël të ekonomisë së tregut dhe i plotësuan me saktësi kërkesat e saj deri në vitin 2004. Këtë mund ta konsiderojmë si faza e parë të reformës në kontabilitet.

Së dyti, rishikimin e rregullimeve kontabël të realizuara në fazën e parë, duke ia përshtatur ndryshimeve të ndodhura në evoluimin e ekonomisë tonë dhe përfshirjen në të, të elementëve të rinj. Ky rishikim erdhi edhe si domosdoshmëri e impenjimit të vendit tonë në marrëveshje e konventa të ndryshme ndërkombëtare si dhe për vetë evoluimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, etj.

Për këtë qëllim u përgatit dhe u miratua ligji “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Nr 9228, datë 29.04.2004 në të cilin u përcaktua se në vendin tonë do të zbatoheshin standardet e kontabilitetit sipas klasifikimit përkatës. Realizimi i këtyre ndryshimeve ka kërkuar punë studimore dhe kërkimore duke shfrytëzuar përvojën botërore, atë të perëndimit të zhvilluar por dhe të lindjes në tranzicion pa lënë mënjane përvojën e vyer shqiptare.

Në vitet e para të tranzicionit nuk gjendeshim në vakum përse i përket kontabilitetit. Ai ekzistonte dhe siguronte informacionin e nevojshëm për aq sa i shërbente një ekonomie të centralizuar. Ne dispononim një literaturë të profesorëve tanë të nderuar, si prof. Xhemil ÇELA, prof. Lefter KRIQI, specialistë të shquar si Pandeli GJIKA, Malo FRASHËRI, Laze FRASHËRI, etj. Kjo literaturë ishte ndërtuar me një frymë perëndimore pasi këta autorë kishin mbaruar studimet e tyre në perëndim.

Në këto dy dekadat e fundit një punë e lavdërueshme është bërë nga anëtarët e KKK, nga pedagogët e Universiteteve, nga Shoqatat Profesionale të cilët kanë punuar për plotësimin me literaturën e nevojshme për përgatitjen e speciliastëve të rinj si dhe për trajnimin e vazhdueshëm të profesionistëve që punojnë në fushën e kontabilitetit.

Në këtë periudhë një kontribut shumë të çmuar ka dhënë Prof. Baki Berberi i cili duke qenë për një kohë të caktuar si Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Kryetar i KKK, ideoi dhe drejtoi reformën në fushën e kontabilitetit në Shqipërisë si pjesë e proceseve integruese të vendit tonë në Europë.

Në proceset e reformimit të kontabilitetit, një kontribut të rëndësishëm ka dhënë dhe Ministria e Financave me strukturat e veta dhe gjej rastin të përshëndes këtu Zotërinjtë Z. Ridvan BODE, Z. Genc RULI, z. Arben MALAJ, z. Anastas ANGJELI dhe Z. Kastriot ISLAMI, të cilëve në emër të KKK dhe emrin tim u shpreh mirënjohje dhe falenderime.

Por misioni i KKK nuk përfundon sot dhe nuk përfundon këtu. Në asnjë mënyrë dhe asnjë profesionist nuk kënaqet vetëm me atë që ka arritur por sheh përtej të sotmes.

Aktualisht, KKK është përfshirë në komponentin 2 “**Forcimi i kapaciteteve të KKK**” të projektit “**Përmirësimi i raportimit financiar të korporatave**” të firmosur nga Qeveria Shqiptare dhe financuar nga Qeveria Zviceriane dhe Banka Botërore, në kuadër të programit REPARIS. Si një produkt shumë i rëndësishëm i këtij projekti është dokumenti i hartuar në bashkëpunim me konsulentin e huaj “Strategjia e zhvillimit të KKK”. Në këtë dokument parashihen disa fusha prioritare strategjike si më poshtë:

A. PËRKTHIMI I SNRF

B. PËRMIRËSIMI I SKK

C. CILËSIA E RAPORTIMIT FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIA ME KUADRIN LEGJISLATIV TË BE NË KËTË FUSHË

Desha shkurtimisht të ndalem shkurtimisht në këtë dokument dhe në planet afatmesme për realizimin e strategjisë sa më sipër.

A. PËRKTHIMI I SNRF

KKK, duke filluar nga pranvera e vitit 2009, është angazhuar me shumë seriozitet në procesin e përkthimit të përditësimeve të SNRF-ve. Deri në këtë moment, kemi të publikuar në faqen e internetit të KKK të gjitha standardet ndërkombëtare dhe komentaret e tyre, varianti 2006, të gjitha përditësimet e tyre, përfshirë përditësimet e vitit 2012 si dhe të gjitha SNRF-të nga 1-13. Seti i fundit i përditësimeve, mbërritur nga Fondacioni i SNRF¹ në muajin Korrik 2012, pas përkthimit dhe rishikimit, i ka kaluar për miratim Ministrinë të Financave dhe sapo ato përditësimet të shpallen zyrtarisht të detyrueshme për zbatim do të publikohen në faqen tonë të internetit. Aktualisht, gjeni në faqen tonë zyrtare edhe fjalorin e termave, përditësim i vitit 2012.

Por, deri më sot, duhet theksuar fakti se ka egzistuar një problem në lidhje me SNRF-të pasi zbatuesit e tyre nuk kanë akoma një variant të konsoliduar ku të jenë përfshirë në variantin bazë, në kohë reale, të gjitha ndryshimet. Pra si thashë më lart, aktualisht janë publikime të veçanta standardet e vitit 2006 dhe të gjitha përditësimet e bëra për to në këto 6 vite. Këtë vështirësi KKK po e tejkalon me ndihmën e konsulentit të huaj, të cilët po përgatisin në bashkëpunim me stafin e KKK variantin e konsoliduar të vitit 2012, dhe këtë detyrë më pas stafi i KKK do ta realizojë me forcat e veta.

Aktualisht është në fazën e miratimit, si pjesë e dokumentit të strategjisë edhe procedura e përkthimit të SNRF-ve:

1. Do të rikonfirmohet komiteti i përkthimit dhe rishikimit të përkthimit duke përfshirë në të edhe përfaqësues nga shoqëritë e mëdha të auditimit, bankave apo shoqërive të sigurimit
2. Do të miratohen pranë Fondacionit të SNRF-ve në Londër procedurat dhe metodologjia e procesit të përkthimit
3. Është prokuruar dhe janë në fazën e trajnimeve anëtarët e Komitetit të Përkthimit dhe Rishikimit me programin e përkthimit TRADOS i cili do të mundësojë konsistencën e përkthimit të termave

¹ Sot nuk emërtohet më IASB por që prej 1 Korrik 2010 emërtohet Fondacioni i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

4. Duke filluar nga viti 2014, KKK do të prodhojë me kapacitet e veta, variantin e konsoliduar të vitit 2013, e kështu do të jetë për çdo vit
5. KKK ka si objektiv, dhe po punon për ta realizuar atë sa më shpej të jetë e mundur, publikimin e variantit në shqip të SNRF-ve të plota në Eëbsite-n e Fondacionit të SNRF

B. PËRMIRËSIMI I SKK

KKK pasi e analizoi problemin, pas botimit të SNRF për SME dhe krahasimit të saj me SKK, arriti në përfundimin se:

1. Mes tyre kishte disa dallime thelbësore të cilat duheshin reflektuar
2. Mes tyre kishte të tjera dallime jo thelbësore
3. Kishte standarde që mungonin

Ruga e zgjidhjes:

1. Të përmirësohen SKK egzistuese duke pasqyruar në to ndryshimet thelbësore
2. Të hartohen SKK që mungojnë
3. Për vitin 2013 të bëhen ndryshimet e mësipërme
4. PF të vitit 2014, të hartohen mbi bazën e SSK të përmirësuara
5. Kur BE të marrë një qëndrim përfundimtar lidhur me adoptimin e SNRF për SME, atëherë KKK do të rishikojë vendimin e saj për setin e zbatueshëm të Standardeve të Kontabilitetit

Arsyet:

1. Profesionistët zbatues të SKK kanë fituar tashmë një eksperiencë 5 vjeçare dhe e kanë më të lehtë reflektimin e ndryshimeve sesa zbatimin e SNRF së plotë të SME-ve
2. Ndryshimet për SNRF për SME bëhen çdo tre vjet dhe jo çdo vit si ndodh me SNRF-të e plota
3. Kemi një memorandum mrëkuptimi me Kosovën ku është rënë parimisht dakord të punohet fillimisht me SKK e përmirësuara

Pse nuk janë bërë përmirësimet deri më tani?

1. Me qëllim që hartuesve të PF t'u lihej kohë e mjaftueshme për t'u përshtatur dhe për të njohur mirë SKK
2. Meqenëse SKK janë një variant i thjeshtuar i SNRF-ve të plota, ndryshimet e ndodhura në këto të fundit nuk ishin domosdoshmërisht të reflektuara në SKK
3. Në vitin 2009 u publikua SNRF për SME dhe mendimi ishte që SKK të përshtateshin me të dhe jo me ndryshimet e tjera të SNRF-ve të plota. Në atë moment KKK vendosi që ta rishikonte vendimin e përmirësimit në një periudhë 2 – 3 vjeçare.

C. CILËSIA E RAPORTIMIT FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIA ME KUADRIN LEGJISLATIV TË BE NË KËTË FUSHË

Manuali i zbatimit të KKK

Një nga detyrat e rëndësishme të KKK është dhe monitorimi i zbatimit të SKK dhe SNRF nga njësitë ekonomike. Por ky monitorim aktualisht është në nivel modest pasi burimet njerzore

të KKK janë shumë të kufizuara. Por ajo ç'ka është më e rëndësishme, është cilësia e zbatimit të Standardeve. Në këtë kontekst, KKK është angazhuar që në zbatim të SKK të përmirësuara, në bashkëpunim me konsulentin të punojë për hartimin e një manuali apo udhëzuesi në zbatim të SKK-ve.

Në këtë udhëzues përveç komenteve teorike do të gjejnë vend mjaftueshëm ilustrimet praktike në zbatim të SKK e sidomos të ndryshimeve të bëra në kuadër të përputhjes më të mirë të SKK me SNRF për SME.

Gjithashtu, është parashikuar që të hartohet dhe një pyetsor në shkallë kombëtare me qëllim krijimin e një database të rëndësishëm lidhur me problemet dhe vështirësitë që hasin zbatuesit e standardeve në praktikën e tyre të përditshme. Këto komente e të tjera si to, gjithnjë të lidhura me pajtueshmërinë e kontabilitetit me standardet e raportimit financiar, padiskutim që do të gjejnë interpretimin apo ilustrimin praktik në këtë manual. Pritet që puna për manualin të përfundojë në verën e vitit që vjen pasi është në fazë përgatitore pyetsori.

Çfarë ka bërë KKK për transpozimin e Direktivës 4 të BE?

KKK prej kohësh mori iniciativën për të përgatitur tabelën e përputhshmërisë mes bazës tonë të raportimit financiar dhe Direktivës 4 të BE. Përfundimet tona, pa mburrje mund të them se ishin të njëjta me ato të Komponentit 1 të projektit të programit REPARIS “Përmirësimi i raportimit financiar të korporatave”. Përsa i përket ndryshimeve mes këtyre dy kuadrove të raportimit mund të thuhet se jo vetëm nuk ka dallime thelbësore por jemi krenarë që kemi bërë një hap kaq cilësor në drejtim të raportimit financiar duke aplikuar në vendin tonë SNRF dhe SKK të cilat janë në koherencë me këto ta parat. Prandaj KKK mbështetur në përfundimet e tabelës së përputhshmërisë se dallimet janë jo thelbësore, do të përfshijë në procesin e përmirësimit të standardeve vetëm pak prej tyre duke u angazhuar se me miratimin e variantit të rishikuar të Direktivës në Qershor të vitit 2013, do të përgatisë një tabelë të re përputhshmërie dhe sërish do të gjykojë duke patur gjithnjë si objektiv transpozimin e legjislacionit të BE në legjislacionin vendas i cili është kusht për integrimin e vendit tonë në BE.

Në këtë aspekt KKK ka përgatitur një draft për disa ndryshime dhe përmirësime në legjislacionin për kontabilitetin dhe PF, të cilin pasi ta diskutojë gjerësisht me palët e interesit do t’ja paraqesë për miratim Kuvendin e Shqipërisë.

Pa dashur të ndalem më gjatë në punën e bërë dhe sukseset e arritura nga KKK por dhe në vështirësitë që KKK ka përballuar në këto vite, dua të vë në dukje një fakt të padiskutueshëm. Realizimi i detyrave për të ardhmen do të kërkojë bashkëpunimin me të gjithë faktorët që kanë kontribuar në këtë fushë.

Ftojme dhe jemi të bindur që do të vazhdojë me një intensitet edhe më të lartë bashkëpunimi me akademikët, shoqatat e profesionistëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Bordin e Mbikqyrjes Publike dhe organizmat rregullatore si Këshilli Mbikqyrës i Bankave, AMF dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që objektivat e caktuara do të mund të arrihen me punë, mirëkuptim dhe angazhim të të gjithë faktorëve të përmendur më lart.

FALEMINDERIT

IAN RITCHIE

SFIDAT E PROFESIONIT TË KONTABILITETIT NË SHQIPËRI NË KONTEKSTIN E SFIDAVE ME TË CILAT PËRBALLET KY PROFESION NË TË GJITHË BOTËN

Zonja dhe zoterinj, miremengjesi. U ndjeva me te vertete mire kur me kerkuan te trajtoja ne kete Konferencë Jubilare çeshtjen e sfidave me te cilat perballet Profesion i Kontabilitetit ne Shqiperi.

Mendoj se fillimisht duhet te prezantohem. Emri im eshte Ian Ritchie dhe jam Drejtues i Ekipit te projektit te financuar nga Banka Boterore per perforcimin e kapaciteteteve te Keshillit Kombetar te Kontabilitetit ne Shqiperi. Une jam profesor ne Universitetin e Skocise Perendimore dhe deri kohet e fundit kam qene drejtor i Qendres se Universitetit per Kontabilitetin Nderkombetar dhe Drejtimin Korporativ. Kam qene dhe jam i perfshire ne hartimin e Standardeve Kombetare te Kontabilitetit ne disa vende, perfshire Polonine, Azerbajxhanin dhe Kazakistanin, dhe jam i lumtur qe jam i perfshire edhe ne hartimin dhe permiresimin e standardeve te kontabilitetit ne Shqiperi.

Projekti yne perfshin dy elemente baze, te cilat ndoshta e permbledhin te gjithe gamen e sfidave me te cilat perballet profesioni i kontabilitetit ne Shqiperi. Elementi i pare i projektit tone eshte ofrimi i asistences teknike per te perforcuar procesin e hartimit te standardeve permes permiresimit te transparences dhe pjesemarrjes me te gjere te paleve te interesuara. Ndersa elementi i dyte eshte krijimi i nje mekanizmi te qendrueshem per adoptimin e Standardeve Nderkombetare te Raportimit Financiar dhe perditesimin e perkthimit te tyre, si pjese e procesit te pranimit te SNRF-ve per perdorim ne Shqiperi.

Sfidat me te cilat perballet Keshilli Kombetar i Kontabilitet jane te pesefishta:

1. Se pari, te arrije te kete nje perkthim te perditesuar te SNRF-ve, duke perfshire edhe SNRF-te per Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme, ne perputhje te plote me procesin e perkthimit te percaktuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit;
2. Se dyti, te ndryshoje dhe te permiresoje Standardet Kombetare te Kontabilitetit ne menyre qe ato te konvergojne me SNRF-te si dhe Direktivat e Bashkimit Evropian per Legjislacionin e Shoqerive;
3. Se treti, te perforcoje procesin e hartimit te standardeve permes permiresimit te transparences dhe pjesemarrjes me te gjere te paleve te interesuara, si dhe permes dhenies se udhezimeve te pershtatshme per te nxitur zbatueshmerine;

4. Se katerti, te percaktoje fushen e veprimit te Standardeve Kombetare te Kontabilitetit per t'u siguruar se, per te gjitha njesite qe jane subjekt i Ligjit per Kontabilitetin, te kete regjime te pershtatshme te raportimit financiar; dhe
5. Se pesti, te permiresoje shkallen e zbatueshmerise te standardeve te kontabilitetit ne Shqiperi.

Keto sfida jane bere edhe me te veshtira per shkak se mjedisi nderkombetar i kontabilitetit dhe i raportimit financiar eshte ne ndryshim te vazhdueshem. Kjo do te thote se edhe Keshilli Kombetar i Kontabilitetit synon drejt nje objektivi qe eshte ne levizje te vazhdueshme. Arsyet pse ky objektivi eshte ne levizje datojne 10 vjet me pare dhe ato jane:

1. Se pari, vendimi i Bashkimit Evropian per te caktuar Bordin e Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit si organin e tij pergjegjes per hartimin e standardeve, gje qe sherbeu si katalizator per pranimin e Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit edhe nga vende te tjera;
2. Gatishmeria e Shteteve te Bashkuara, se pari per te pranuar SNRF-te per shoqerite joamerikane, dhe se dyti per te shqyrtuar mundesine e perdorimit te tyre edhe per shoqerite amerikane.

Ne vitin 2002, BE-ja mori vendimin qe te gjitha shoqerite e listuara ne nje burse te Bashkimit Evropian duhet te zbatonin SNRF-te ne pergatitjen e pasqyrave financiare - kjo eshte e famshme Rregullore 1606. Ne te njejten kohe, gatishmeria e Shteteve te Bashkuara per t'u angazhuar ne procesin e konvergences çoi ne nenshkrimin e *Marreveshjes se Norwalkut* ne fillim te vitit 2002. *Marreveshja e Norwalkut* eshte nje program konvergjence i perbashket dhe intensiv, qe ka qene nje pike e rendesishme e axhendes se Bordit te Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit vitet e fundit. Ky program konvergjence ka gjeneruar dhe vazhdon te gjeneroje ndryshime te rendesishme tek SNRF-te, gjate kohes kur SNRF-te dhe Parimet e Kontabilitetit Gjeresisht te Pranuara ne SHBA, perafrohen gjithnje e me shume.

Me pas, ne korrik te vitit 2006, Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit shpalli nje moratorium mbi ndryshimet ne SNRF-te sipas te cilit te gjitha ndryshimet ne rregulloret e standardeve nderkombetare te kontabilitetit do te pezulloheshin deri ne vitin 2009. Kjo mase u mor ne pergjigje te shume shoqerive ne Bashkimin Evropian te cilat ishin shprehur se ato ishin ende duke i pershtatur sistemet e tyre te kontabilitetit qe nga prezantimi i SNRF-ve per here te pare ne vitin 2005, i cili kishte rezultuar me kompleks nga sa ishte parashikuar.

Sigurisht, qe moratoriumi tani ka perfunduar dhe ne shohim nje rrjedhe te vazhdueshme ndryshimesh ne SNRF, ndryshime te cilat shoqerite duhet t'i kuptojne dhe t'i inkorporojne ne metodologjite dhe sistemet e tyre te kontabilitetit. Ndryshimet e bera deri tani shkojne pertej ndryshimeve te vogla te natyres se raportimit. Ne fakt vete parimet mbi te cilat bazohen shume SNRF jane duke u ndryshuar, nderkohe qe Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit rishikon standardet nje nga nje.

Ne shtator te vitit 2010 bordi njoftoi se faza e pare e kuadrit konceptual, e cila kishte te bente me karakteristikat objektive dhe kualitative te raportimit financiar, kishte perfunduar. Keshtu per shembull, ne mund te shohim se qellimi i pasqyrave financiare ka ndryshuar.

Ai ka qene: Qellimi i pasqyrave financiare eshte te jape informacion ne lidhje me pozicionin financiar, performancen dhe ndryshimet ne pozicionin financiar te nje njesie, qe eshte i dobishem per nje game te gjere perdoruesish ne marrjen e vendimeve ekonomike.

Dhe eshte bere: Qellimi i raportimit financiar me qellim te pergjithshem eshte te siguroje informacion financiar ne lidhje me entitetin raportues qe eshte i dobishem per investitoret kapitale, aktuale dhe potenciale, huadhenesit dhe kreditoret e tjere, ne marrjen e vendimeve ne cilesine e tyre si ofrues kapitali.

Ndryshimi i theksit nga "nje game e gjere perdoruesish" ne nje "game me te ngushte perdoruesish" nenkupton qe SNRF-te pritet te behen me teknike ne permbajtje, duke supozuar se pasqyrat financiare do te perdoren nga nje game e kufizuar perdoruesish te sofistikuar. Por Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit ka vleresuar tashme se SNRF-te e plota i ngarkojne me nje barre shume te madhe njesite e vogla dhe te mesme dhe per kete arsye, ne vitin 2009, ata prezantuan SNRF-te per Ndermarrjet e Vogla dhe te Mesme. SNRF per NVM nuk ndryshohen çdo vit por ne nje cikel tre vjeçar. Rishikimi i pare i ketij standardi pritet te ndodhe ne nje te ardhme te afert.

Me prezantimin e ketij standardi, bota u njoh me raportimin financiar te diferencuar. Ai pati nje ndikim ne Direktivat e BE-se mbi Legjislacionin e Shoqerive. Jam i sigurt qe ju jeni ne dijeni se BE-ja aktualisht po shqyrton Direktiven 4 dhe 7, dhe ne jemi ne pritje te nje direktive te re te kombinuar ne vitin 2014.

Pra, ne perfundim, mund te themi se kontabiliteti global po kalon nje periudhe ndryshimi te madh, ku sfida me madhore e profesionit te kontabilitetit ne mbare boten eshte pershtatja dhe ecja ne te njejtin ritem me kete ndryshim.

Por si do te ndikojte e gjithë kjo ne profesionin e kontabilitetit ne Shqiperi? Do te doja te jepja kater aspekte ne lidhje me kete:

1. Se pari, eshte e nevojshme pershtatja me ndryshimet e SNRF-ve. Kjo kerkon investim gjithnje e ne rritje ne Zhvillimin e Vazhdueshem Profesional te profesionistev te kontabilitetit ne Shqiperi. Kontabilistet shqiptare duhet te jene plotesisht te njohur me ndryshimet, ne menyre qe t'i zbatojne ato ne raportimin korporativ ne te gjithë vendin.
2. Se dyti, eshte i nevojshem permiresimi i Standardeve Kombetare te Kontabilitetit ne menyre qe raportimi financiar per ndermarrjet shqiptare te vogla dhe te mesme t'i afrohet standardit nderkombetar. Barra per permiresimin e standardeve bie mbi Keshillin Kombetar te Kontabilitetit, por barra per zbatimin te tyre bie mbi te gjithë profesionin e kontabilitetit.

3. Se treti, eshte e nevojshme qe te mendohet mbi kontabilistet e se ardhmes. Mjedisi i raportimit financiar ka ndryshuar dhe do te vazhdoje te ndryshoje dhe trajnimi dhe kualifikimi profesional duhet te fokusohen ne aftesite qe kontabilistet dhe audituesit duhet te kene per t'iu pershtatur nje mjedisi ne ndryshim te vazhdueshem.
4. Dhe se fundi, eshte i nevojshem edukimi i perdoruesve te pasqyrave financiare. Qellimi kryesor i pasqyrave financiare eshte te "japin informacion financiar qe eshte i dobishem ne marrjen e vendimeve." Nese perdoruesit nuk i kuptojne pasqyrat financiare, atehere pasqyrat financiare, sipas perkufizimit me lart, nuk mund te jene te dobishme. Kjo eshte ndoshta sfida me e madhe per profesionin e kontabilitetit.

Nga ana ime, shpresoj qe ekipi im te luaje nje rol te vogel ne kete proces ndryshimi dhe zhvillimi ne Shqiperi. Qellimi i projektit tone eshte te ndihmoje Keshillin Kombetar te Kontabilitetit ta nise kete proces dhe te planifikoje ndryshime dhe permiresime per nje periudhe afatmesme. Suksesi afatgjate i ketij ndryshimi varet nga ju, anetaret e Profesionit te Kontabilitetit dhe une ju uroj suksese ne permbushjen e ketyre sfidave.

Faliminderit.

PROF.DR. LEANDRO HAXHI

ZHVILLIMET NË FUSHËN E KONTABILITETIT DHE TË PROFESIONEVE PËR KONTABILITETIN

Sistemi ekonomik i cdo vendi do të mund të funksionojë normalisht dhe pa shumë probleme në se drejtimi i cdo njësie ekonomike merr në tërësi një informacion të saktë dhe të shpejt. Ndër informacionet e shumta që përdor drejtimi i çdo njësie ekonomike, kontabiliteti luan rol të vecantë.

Kontabiliteti, vazhdimisht dhe pa ndërprerje i siguron drejtimit të njësisë ekonomike dhe më gjerë, informacion të shpejt, të saktë, rigorozisht të dokumentuar dhe të shkruar. Ai i jep drejtimit të njësisë ekonomike informacion të plotë për gjendjen financiare të njësisë, për suksesshmërinë e saj dhe për faktorët që kanë ndikuar sipas rastit në arritjet e veprimtarisë ose në mos arritjet e saj. Prandaj themi që nga informacioni që merret nga kontabiliteti i sigurohet drejtimit të njësisë ekonomike “sytë dhe veshët” e nevojshme për një drejtim sa më efikas të veprimtarisë ekonomike, është pika e nisjes të të gjithë drejtimit financiar të saj.

➤ Në vendin tonë, edhe para fillimit të shekullit të kaluar, jo vetëm në periudhën e ekonomisë së centralizuar por edhe shumë kohë para saj është shkruar dhe është mbajtur kontabilitet. Patrioti dhe Rilindasi Jani Vreto që ne vitin 1889 në librin e tij “**RADHUESHKRONJË**” shtypur në shtypshkronjën “Dituri” në Bukuresht ka shkruar për nevojën e mbajtjes të hesapeve të mara e të dhena. Ja si shprehet ai që në fillim:

“Radhueshkronja thuhet të shkruarit e të dhënave dhe e të marrave në fletore a ndryshe libra që quhen rradhua. Po vecan Radhueshkronjë quhet mësimi i te shkruarit atyre mjeshtëreve që kurdoherë me pak punë në të shkruar të mund të dinë se ku gjenden. Radhueshkronja cdo njeriu që ka të dhena e të marra i është i vyer, por tregtarëve u është që pa te s’bëhet. Ndaj tregtari që mban radhon të drejte e te qëruarë, veç të mires që siç thamë, kurdoherë mund të dijë se ku gjendet dhe të kanonisje punët e tij e të marrë përpara, fiton edhe nderin e të zënit bese, si njeriu që ka punët e tij të drejta dhe të qëruara prej njerezisë që duhet, le edhe trashëgonjësit kur të vdesë”. Në vijim, në këtë libër, autori ka hartuar ditarin për gjendjen, për te marrat dhe të dhënat e mjeteve monetare (grosh).

Kontabilitet, madje dhe duke zbatuar parimin e rregjistrimeve të dyfishta, është mbajtur që në kohën e sundimit otoman. Po kështu, sot në arshivat tona gjenden bilancet e periudhës së qeverisë së Ismail Qemalit për shoqëritë vendase dhe të huaja që zhvillonin veprimtari në vendin tonë.

Në periudhën e mbreterisë me ligj te posaçëm “Për Administrimin e Pasurisë dhe Kontabilitetin e Përgjithshëm të Shtetit” të dates 31 korrik 1928 dhe të miratuar me dekret të Mbretit Zogu i Parë me datën 28 maj 1929, janë sanksionuar në mënyrë moderne te gjitha problemet që lidhen me kontabilitetin, administrimin dhe sistemin e thesarit në vendin tonë. Më hollësisht, për sanksionimin me ligj të shumë problemeve financiare në këtë periudhë, shkruan edhe inspektori i përgjithshëm i oborrit mbretëror Haxhi Shkoza në punimin e tij “Financat e Shqipnis” (1839-1934).

Kështu, përjashtuar periudhën e sundimit otoman, mbajtjen e kontabilitetit në vendin tonë mund ta ndajme në tre periudha:

- i) nga shekulli i XIX deri në vitin 1944,
- ii) nga viti 1944 deri në vitin 1991
- iii) nga viti 1991 deri në ditët e sotme

Në periudhën 1944-1991, pra në kushtet e ekonomisë së centralizuar, për nga qëllimi i mbajtjes së kontabilitetit, kam mendimin se ai ka qenë i plotë. Sigurisht rregullimi kontabël nuk bëhej me një ligj të veçantë për kontabilitetin por bëhej në bazë të një plani unik kontabël të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave i cili përcaktonte rregullat bazë të ndërtimit të Pasqyrave Financiare, listën e llogarive dhe funksionimin e tyre. Ka ekzistuar një plan unik kontabel me kritere të përgjithshme dhe të njejta për tu zbatuar nga të gjitha degët e ekonomisë. Për çdo degë të ekonomisë siç ishin industria, bujqësia, tregtia, ndërtimi ,etj kishte plane kontabël te veçanta që u përgjigjesh veçorive të cdo dege. Brenda çdo dege kishte edhe veçori më të detajuara, pa haruar këtu edhe plane kontable të veçanta për institucionet buxhetore, për bankat, për kooperativat bujqësore, etj. Sigurisht, si edhe tërë politika e asaj periudhe edhe informacioni që përgatitesh nga kontabiliteti i shërbente zbatimit të direktivave të partisë shtet, parullës famëkeqe “të ndërtojme socializmin me forcat tona”. Ishte kjo arsyeja që shkolla e mbajtjes së kontabilitetit në atë periudhe ishte ajo Europiane Lindore apo Ruse; nuk bëhej fjalë për shkollat perëndimore të kontabilitetit edhe pse edhe shkolla Lindore zanafillën e saj për kontabilitetin dhe statistikën e kanë në atë perëndimore.

Në këtë periudhë, informacioni kontabël dhe vetë kontabiliteti ishin të orientuara vetëm drejt ruajtjes së vlerave materiale e të administrimit të pasurisë shtetërore; kontabiliteti analitik ishte tepër i detajuar dhe shumë i rënduar dhe që shkonte deri në prekjen e parimit të kosto-perfitimit; nuk kishte ndarje të qartë dhe të dalluar të kontabilitetit financiar nga kontabiliteti i koston sikurse në kushtet e mungesës së drejtimit real nga ana e drejtuesëve të njësisë ekonomike, nuk bëhej fjalë për kontabilitetin e drejtimit. Ky i fundit barazohej me analizën e veprimtarisë ekonomike e financiare të ndermarjeve. Ishte kjo arsyeja që specialistët e mbajtjes së kontabilitetit ishin tepër të ngarkuar me punë, angazhoheshin më tepër me punë mekanike për të bërë regjistrimet dhe këto të gjitha me dorë sepse nuk bëhesh fjale për programet kompjuterike që zbatohen sot. Në mes të viteve '60 në kuadër “të luftës kundër burokratizmit”, u ndërmor fushata për thjeshtimin e të dhënave që nxirreshin nga informacioni kontabël, madje u arrit në teprime. Kështu u hoq dorë nga llogaritja e koston së prodhimit për shumë prodhime veçanërisht në industri dhe u zëvendësua me treguesin “të ardhura për njëqind lekë shpenzime”.Të tilla “thjeshtime” u bënë shumë për rrjedhojë u shkurtuan shumë vende pune në personelin e zyrave të kontabilitetit në ndermarje ose zbritje në pozicionet e punës. Në përgjithësi mënyra e mbajtjes së kontabilitetit në këtë periudhë ishte manuale; vetem pas viteve '70 filloi që për një pjesë fare të vogël të ndermarrjeve, madje edhe për një pjesë të kooperativave bujqësore, kontabiliteti të mbahej i mekanizuar në qendrat e evidences kontable. Jo vetem në ndërmarrjet dhe në kooperativat bujqësore në tërësi por edhe në këto qendra, të dhenat që mbaheshin për shpenzimet ishin aq të detajuara sa arrihesh deri në teprime. Kështu psh në bujqësi shpenzimet vazhdimisht janë mbajtur jo vetëm për cdo kulture dhe lloj të gjës së gjallë por edhe sipas zërave të vecanta të shpenzimeve. Dikush sot me të drejtë mund të thotë që ishte një evidentim me vlerë. Mund të ketë të drejtë, mirëpo përse shërbente një mbajtje kaq shumë e detajuar, kush e shfrytëzonte atë? As që bëhej fjalë që ky informacion të përdorej për marrjen e vendimeve nga drejtuesit e

ndërmarrjeve. Ai përdorej kryesisht dhe vetëm në nivelin e planifikimit nga organet e larta në rang ekonomie ose thjesht për propagantë.

Në këtë periudhë as që bëhej fjalë për profesionin e mirëfilltë të kontablit - ata mbeten rregjistruar të thjeshtë të shifrave, ndërtues të thjeshtë të pasqyrave financiare. Rallë herë kërkohet mendimi i tyre i specializuar për problemet ekonomike; por kur vinte rasti i përgjegjesisë madje shpesh edhe pse nuk realizoheshin treguesit ekonomik me përgjegjësi ngarkohet edhe financieri, shpesh edhe deri në denime me privim lirie me te famshin nen të kodit penal “sabotim në ekonomi”. Në se deri në fund të viteve ’50 të shekullit të kaluar, kontabilistët ishin specialist të përgatitur kryesisht me arsim të mesëm në shkollën tregtare të Vlorës (1924), në shkollat e mesme të vendeve të tjera, në shkollat e mesme ekonomike të vendit tonë pas çlirimit (teknikumit financiar, ekonomik dhe atij tregtar) ose me kurse të veçanta afatshkurtra, pas këtij viti Fakulteti i Ekonomisë në Tiranë dhe më vonë Fakulteti i Ekonomisë Agrare në Universitetin Bujqësor, përgatiten specialist të mbajtjes së kontabilitetit me arsim të lartë, madje në vitin 1959, Fakulteti i Ekonomisë diplomoi kontigjentin e parë prej 30 vetash “Specialist për Kontabilitetin”. Përgatitja e kësaj armate të madhe specialistesh të profilit ekonomik në shkollat tona të larta, publike apo private si dhe kualifikimi i tyre i mëtejshëm, kam bindjen se është garancia më e madhe për zbatimin e të rejave të shkencës në mbajtjen e kontabilitetit.

➤ Kështu, në periudhën e tretë që i përket vitit 1991 deri në ditët e sotme, reforma kontable e inicuar në vitin 1991 nga Ministria e Financave, nuk filloi në boshllëk. Natyrisht ndryshimet social ekonomike të ndodhura në këtë kohë, diktonin reformime edhe në fushën e kontabilitetit ashtu si dhe në të gjitha fushat e tjera të jetës sonë. Në këtë kohë reforma në fushën e kontabilitetit kishte dy objektiva kryesore:

Së pari, ndryshimet në dispozitivat rregullator të kontabilitetit në menyrë që ky t’u përgjigjej kërkesave të një ekonomie tregu dhe të ishte në pajtim me harmonizimin europian e më gjerë.

Së dyti, organizimin e profesioneve të lira kontabel siç ishte ai i Kontabilistit të Miratuar dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (audituesit).

Realizimi i objektivit të parë iu besua një grupi personash të cilët pas miratimit të ligjit “Për Kontabilitetin” u formalizuan si anëtare të Këshillit të parë Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) dhe që ishin nxënësit e mësuesave dhe kontributorëve më të hershëm në fushën e kontabilitetit. Edhe këta mbeten si kontribuesit kryesor të reformës në kontabilitet dhe si pjestar i këtij grupi midis nënte anëtareve të parë të KKK dua të veçoj kontributin kryesor të kryetarit Baki Berberi dhe përfitoj nga rasti të shpreh edhe një herë nderim të veçantë për këtë figurë të çmuar në fushën e kontabilitetit dhe të reformës në sferën ekonomike dhe financiare.

Në kuadrin e dispozitivit rregullator të kontabilitetit me të drejtë këshilli zgjodhi normalizimin e tipit kontabël mbështetur në sistemin francez dhe kjo sepse:

i) Në Shqipëri normalizimi kontabël ka qenë realizuar të paktën që nga viti 1947 e këtej nëpërmjet ligjeve dhe akteve nënligjore. Planet kontable unike dhe planet kontable sektoriale të hartuar dhe të miratuara nga organet e shtetit (Ministria e Financave) kanë qenë çelsat e këtij normalizimi. Kjo kërkonte që tradita e Shqipërisë si vend i vogël i së drejtës së kodifikuar duhej ruajtur dhe paralelisht me këtë duke ndryshuar objektivat, fushën e shtrirjes dhe formën e normalizimit. Në këtë mënyrë specialistët e kontabilitetit duke qenë të mësuar që të punojnë me rregulla të fiksuara do ta kishin më të lehtë zbatimin e një sistemi kontabel të ri. Dhe kjo ndodhi;

duke justifikuar besimin e një numuri të madh të brezit tonë që kontabiliteti në kushtet e ekonomisë së tregut do të gjente zbatimin e tij të shpejtë dhe të plotë.

ii) Normalizimi kontabël në vendin tonë duhet të mbulonte një fushe të gjerë zbatimi. Njëherazi, ai duhet të shtrihej jo vetëm në përgatitjen dhe publikimin e gjendjeve financiare por edhe në mbajtjen e kontabilitetit.

iii) Në kushtet që profesionalistët kontabël shqiptar, me pak përjashtime, ishin larg njohjes së parimeve dhe normave kontabël ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar, ishte e nevojshme që këto parime e norma të paraqiteshin të sistemuara në tekste unike dhe me një natyrë metodike. Plani Kontabël i Përgjithshëm ishte një instrument mjaft i përshtatshëm për këtë qëllim dhe lehtësonte zbatimin e këtyre normave e parimeve praktike.

iv) Normalizimi i tipit kontinental mban parasysh lidhjen e fortë midis kontabilitetit dhe fiskalitetit dhe rezultati kontabël është bazë për llogaritjen e tatimit. Që këtej doli nevoja e një Plani Kontabel të Përgjithshëm dhe një klasifikim të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës. Fillimisht, barra për vënien në jetë të këtij Plani i ra armatës së madhe të kontabilistëve dhe me vonë, duke filluar nga mezi i vitit 2000 edhe pjesës më të kualifikuar, Kontabilistëve të Miratuar që aktualisht arrijnë rreth 900 nga të cilët një pjesë e madhe prej tyre kanë ngritur zyrat e tyre te profesionit.

Në vështrim si me sipër, pas futjes në ekonominë e tregut, zhvillimi i rregullimit kontabël mund të ndahet në dy periudha:

i) Nga fillimi i viteve '90 deri në vitin 2004

ii) Nga viti 2004 e në vijim.

Periudha e parë karakterizohet nga ndryshime të thella, të shpejta dhe radikale politike dhe ekonomike, për rrjedhojë edhe në fushën e kontabilitetit. Ekonomia e tregut të lire, hapja e sipërmarjeve private si dhe rritja e rolit të drejtimit në vendimmarrje, kërkonin domosdoshmërisht edhe rritjen e rolit të informacionit që jepte kontabiliteti. Kështu, kontabiliteti fiton një rol të ri krahas rolit tradicional të informacionit në lidhje me ruajtjen dhe administrimin e pasurisë. Ai tashti duhet të bëhet përcaktues në vendimmarrjen e drejtimit të njësisë ekonomike. Por këto ndryshime dhe në përputhje me kushtet e reja të krijuara kërkonin që të shoqëroheshin edhe me masa të tjera të nevojshme për të siguruar rregullimin e kontabilitetit në mënyrë që t'i përgjigjej kërkesave aktuale dhe në perspektivë.

Pra, jemi në periudhën e tranzicionit, shumë ndryshime ndodhen paralelisht edhe në kontabilitet u ndërmorën një sërë hapash të cilat për nga natyra dhe rëndësia që paten synuan dy qëllime kryesore:

i) Sistemi kontabel dhe zhvillimi i tij duhet të riformoheshin.

ii) Duhet të krijoheshin dhe të zhvilloheshin profesionet e lira me bazë kontabilitetin.

Për vënien në jetë të qëllimit të parë emergjente ishte përcaktimi i disa rregullave dhe formulimi i disa udhëzimeve sigurisht të përkohshme si për përshtatjen e kontabilitetit në kushtet e ekonomisë së tregut ashtu dhe për plotësimin e pasqyrave financiare. Përpjekja e parë u ndërmor në janar të vitit 1991 ku doli edhe ligji i parë për kontabilitetin i cili për mangësitë që pati, me asistencën edhe të të huajve, u zëvendësua dhe hyri në fuqi ligji “Për Kontabilitetin” i vitit 1993. Në zbatim të tij në korrik të po këtij viti, ky ligj u shoqërua me “Planin Kontabël të

Përgjithshëm” i cili përcaktonte rregullat dhe parimet bazë të mbajtjes së kontabilitetit, të funksionimit të llogarive dhe ndërtimin e pasqyrave financiare sikurse pas disa viteve u miratua plani kontabël i Institucioneve Buxhetore dhe Manuali Kontabël i Bankave.

Fillimi i viteve '90 ishte një periudhë mjaft intensive në hartimin e legjislacionit në fushën e kontabilitetit dhe të auditimit. Kështu ligji i vitit 1992 “Për Shoqëritë Tregtare” hodhi bazat e para për krijimin e profesionit të lirë të audituesit, të rregullave për miratimin dhe publikimin e pasqyrave financiare. Ishte kërkesë e investitoreve publike dhe aksionarëve për të patur një auditues të pasqyrave financiare mbasi ata kane investuar kapitalet e tyre. Në kushtet e ekonomisë së tregut, koncepti i ri në veprimtarinë e profesionistëve kontabël kërkonte që në Shqipëri duhej filluar menjëherë puna për përgatitjen e legjislacionit, legalizimin, kualifikimin dhe përgatitjen e specialistëve përkates nga profesionistët ekzistues. Dhe kjo punë u bë paralelisht me vetë njohjen dhe vënien në jetë të planit të ri kontabel. Roli i audituesit nga viti në vit rritej, në Shqipëri filluan të operojnë edhe shoqëri audituese të rangut botëror siç ishin Deloitte&Touche, Ernst&Young, KPMG, etj të cilat auditojnë kryesisht shoqëri të huaja të cilat janë filjale të këtyre shoqërive pjesmarrëse në bursën e shtetit të tyre e më gjerë. Në fund të viteve '90 në vendin tonë filloi të funksionojë profesioni i “Kontablit të Miratuar” i rregulluar në përputhje me kërkesat e ligjit “Për Kontabilitetin” dhe Urdhëresës të Ministrit të Financave. Kështu në fund të vitit 2000 kur u formatua lidhja e veçantë, Lidhja Profesionale e Kontabëlve të Miratuar, sot Instituti i Kontabëlve të Miratuar, në gjirin e saj kishte 114 anetarë ndërsa sot numëri i anetarëve është tetëfishuar.

Të dy këto profesione gjatë dhjetëvjeçarit të fundit janë forcuar dhe perfeksionuar mjaft jo vetëm në mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe auditimin e pasyrave financiar për treguesit e veprimtarisë së njësive ekonomike, por kanë rritur dhe forcuar më tej rolin e tyre në drejtim të ngritjes cilësore të shërbimeve që ato ofrojnë, të rritjes së efektivitetit të shërbimeve dhe në garantimin e investitorëve në besueshmërinë dhe rolin e këtyre profesioneve. Kjo bëri që ne mars të vitit 2009 të miratohet ligji për të dy profesionet e lira, atë të kontablit të miratuar dhe të audituesit të cilët përkatësisht, krahas të drejtës që kanë për përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare, u jepet e drejta edhe për konsulencë të pavarura të shoqërive të ndryshme për probleme finance, analizë të pasqyrave financiare, probleme fiskale, plane studimore të tregut, vlerësimin e shoqërive, procedurat e krijimit dhe likuidimit të shoqërive tregtare, etj. Të dy këto profesione, në fillim ai i audituesit (Instituti i Eksperteve të Autorizuar- IEKA) dhe me pas Kontablit të Miratuar (Instituti i Kontabëlve të Miratuar – IKM) janë anëtarësuar në organizata prestigjioze ndërkombetare siç është IFAC “Federata Ndërkombetare e Kontabilitetit” dhe SEE PAD “Partneriteti i vendeve të Europës Lindore për zhvillimin e profesionit kontabël” ku përfaqësues të të dy profesioneve marrin pjesë rregullisht në takimet e organizuara ku prezantohen përvojat më të përparuara në të dy profesionet, shkëmbehen eksperiencat dhe zhvillohen seminare kualifikuese.

Janë këto dy profesione si dhe shoqata e kontabilistëve që më tepër se çdo organizëm tjetër ballafaqohen përditë me probleme që kërkojnë zgjidhje, madje në ballë të luftës së informalitetit në ekonomi. Pronarët e njësive ekonomike nga njëra anë dhe profesionistët kontabel nga ana tjetër kanë interesa të njëjta për të rritur sa më shumë fitimin e njësive ndërsa kur vjen problemi i llogaritjes së detyrimeve ndaj shtetit për tatimin mbi fitimin, të parët kërkojnë me çdo mënyrë ta ulin këtë. Kjo vjen për faktin se në periudhën që kalojmë një pjesë e sipërmarjeve shqiptare janë ende larg ndërgjegjesimit dhe vlerësimit të evidencës kontable, të nevojës së dokumentimit të rregullt dhe aq më pak të përpjekjeve të kontabilistëve dhe rolit që ata kanë në rritjen e efektivitetit të veprimtarisë dhe të vendimarrjes së tyre. Jo në të gjitha njësitë ekonomike, nga

ana e drejtuesve kërkohet ndihmesa e kontabilisteve për të hartuar programe ekonomiko-financiare të zhvillimit të njësisë së tyre dhe duke shtuar ketu edhe mungesën e tregjeve financiare të zhvillimit të njësisë ekonomike publike, janë faktorë që nuk stimulojnë një raportim cilësor e të besueshmëri financiar dhe të një profesioni të zhvilluar të kontabilisteve. Por ka mjaft shoqëri tregtare, veçanërisht në ato të mëdha, ku profesioni i kontabilistit është i fortë dhe tepër i kualifikuar, që raportimi financiar është cilësor dhe i besueshmë, për rrjedhojë ndihmon përdoruesit në marrjen e vendimeve të drejta dhe efikase.

➤ Shqipëria, në dhjetevjeçarën e fundit vazhdimisht punon dhe synon integrimin e saj në Bashkimin Europian. Kjo midis të tjerave kërkon reflektim dhe zhvillim edhe në rregullat kontabile. Pas viteve 2000 edhe në nivel ndërkombëtar pati zhvillime të rëndësishme në fushën e kontabilitetit. Pati rishikim rrënjësor në një sërë standarde ndërkombëtare të kontabilitetit, u përpunuan dhe u nxoren një sërë standarde të tjera të reja ndërkombëtare të kontabilitetit; informacioni financiar që raportonin njësitë ekonomike bëhet më cilësor për rrjedhojë dhe më i besueshmë për përdoruesit e tij.

Në vitin 2003, qeveria hartoi një strategji për një reformë të re në fushën e kontabilitetit dhe të profesioneve me bazë kontabilitetin me qëllim përmirësimin e rregullimeve kontabël për të rritur më tej trasparencën dhe besueshmërinë e informacionit financiar dhe për t'u përgjigjur sa më mirë nevojave të tregut dhe për mbrojtjen e interesave të publikut dhe të shtetit. Kjo strategji parashikonte edhe rishikimin e rregullimit kontabël ekzistues dhe hartimin e një ligji të ri për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare. Ligji "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i prillit të vitit 2004 me ndryshimet që ju bënë në vitin 2006, ishin materializimi i kësaj strategjie dhe ç'është më kryesorja ky ligj është formuluar nën frymën e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit duke autorizuar rregullimin e kontabilitetit jo me Plan Kontabël të Përgjithshëm por me Standarde Kontabël. Ligji detyron që standardet të hartohen në nivel kombëtar dhe në koherencë me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe të zbatohen nga shumica e shoqërive, ndërsa shoqëritë e huaja që operojnë në vendin tonë dhe të kuotuarat në burse, shoqëritë bankare dhe ato financiare do të zbatohen SNK pa asnjë ndryshim. Ligji formaton Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) duke i dhënë atij rol dhe pozicion ndryshe dhe duke e bërë atë një organ të pavarur në vendimarrje në fushën e kontabilitetit. Këshili në fund të vitit 2006 publikoi 14 Standarde Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të cilat filluan me ligj të zbatohen në janar të vitit 2008 dhe në vitin 2009 u hartua dhe filloi të zbatohet SKK 15 i cili vlen vetëm për mikronjësitë duke siguruar një lehtësim jo të vogël të tyre nga kostot e larta të përgatitjes të informacionit kontabël.

Përvoja e këtyre viteve të fundit tregon që standardet e kontabilitetit si ato kombëtare dhe ato ndërkombëtare, janë zbatuar gjerësisht nga njësitë ekonomike duke e ngritur më tej rolin dhe efektshmërinë e informacionit që serviret për vendimarrje. Kjo ka rritur më tej besueshmërinë e informacionit financiar për zhvillimin ekonomik të vendit dhe për hyrjen e investimeve të huaja, pasi besueshmëria dhe sinjeraliteti i këtij informacioni zhvillon tregjet e kapitalit dhe sigurinë e duhur për të marrë vendime. Rastet e skandaleve në ENRON, Parmalat, Eorlcom e gjetkë janë shembuj të rolit negativ të informacionit të gabuar dhe shtrëmbërimeve të bëra në pasqyrat financiare të përgatitura nga kontabiliteti i këtyre kompanive. Dëmet patën një shtrirje të gjerë duke filluar nga aksionaret e këtyre kompanive që humbën kapitalet e tyre, shumë shoqëri të lidhura me to falimentuan, u dëmtuan bankat dhe punonjësit humbën vendet e tyre të punës. Kontabiliteti është ai që jep sinjalin e parë të çdo krize ekonomike prandaj duke zbatuar me

korektesi standardet kombëtare të kontabilitetit të harmonizuara mirë me ato ndërkombëtare, do të arrihet që kontabiliteti të përgatisë dhe japi informacion të besueshëm, të saktë dhe cilësor. Në mbyllje të kesaj paraqitjeje, kam dëshirë të shpreh edhe në këtë auditor të nderuar, një ndjesi të veçantë dhe detyrën e çdo brezi nga armata e kontabilistëve që herë pas here të flasim dhe të shkruajmë për këtë informacion kaq të vlefshëm dhe të pazëvendësueshëm. Për fat të keq dhe në mënyrë të veçantë në specialistët e kontabilitetit, ndërsa tërë kohën punojmë mbi shifra, shkruajmë raporte dhjetra faqesh, japim mendime dhe sugjerojmë zgjidhje me vlerë, pak vëmendje i kushtojmë anës historike të veprimtarisë sonë dhe njëherësh lëmë në haresë Ata që kanë kontribute të vlefshme në këtë fushë. Dhe këta janë të shumtë. Kështu, brezi të cilit i takoj edhe une, duhet në radhë të parë të përmendim me mirënjohje të thellë dhe respekt mësuesit tanë: Profesorët Xhemil Cela, Lefter Kriqi dhe Aristotel Pano, specialistët e shquar Pandeli Gjika në Ministrinë e Financave, Laze Ajazi në atë të Bujqësisë, Malo Frashërin në Industri, Lefter Cave në Tregëti, Vangjel Karajanin në Ndërtim e shumë të tjerë. Kam patur shansin, madje do të thoshja fatin që kam jetuar dhe kam punuar me këto personalitete të shquara në fushën tonë dhe mund të them me bindje që prej tyre si une ashtu dhe koleget e tjerë që kemi patur fatin të punojmë me 'ta, kemi përfituar shumë për aftësimin tonë profesional dhe më gjerë.

**ASLLAN SHERA
YLBER BEZO**

**ROLI I MINISTRISË SË FINANCAVE NË MBËSHTETJEN E RREGULLI-
MEVE KONTABËL DHE TË PROFESIONEVE TË KONTABILISTËVE
DHE AUDITUESVE**

Kontabiliteti është një nga instrumentat më të rëndësishëm dhe objektiv për informimin, mbikqyrjen dhe orientimin e njësive ekonomike, në funksion të sipërmarrësve, të kreditorëve, shtetit, publikut dhe të të interesuarve të tjerë. Me qëllim që ai të jetë i lexueshëm për të gjithë të interesuarit, i krahasueshëm dhe i besueshëm, format e mbajtjes së tij dhe mënyrat e formulimit të pasqyrave përmbledhëse financiare janë zhvilluar e përmirësuar vazhdimisht deri në nivelin e tanishëm, kur janë përpunuar e publikuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit e të Raportimit Financiar, mbi bazën e të cilave janë përgatitur edhe Standardet.

Nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit janë përkthyer Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar, të azhornuara vit pas viti. Ne kemi në dorë sot setin e plotë të këtyre standardeve, të cilat janë bërë të detyrueshme për një kategori të caktuar të njësive ekonomike, të parashikuara nga ligji, duke filluar nga viti 2008. Po kështu, nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit janë përpunuar Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet Kontabile për njësitë e vogla apo mikronjësitë ekonomike. Pra mund të themi se në Shqipëri sot ekziston baza rregullative për kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

Përveç karakterit detyrues me ligj, mendojmë se implementimi i këtyre standardeve dhe përgatitja e paraqitja e pasqyrave financiare në përputhje me ta, ndikojnë rëndësishëm pozitivisht në formalizimin dhe vënjen në efikasitet e burimeve financiare, materiale e njerëzore, në unifikimin e përgatitjes së pasqyrave financiare, për tu bërë të krahasueshme në kohë e hapësirë, madje të krahasueshme me pasqyrat financiare të sipërmarrjeve të huaja, gjë që rrit mundësinë e interesimit të investitorëve të huaj për të investuar në Shqipëri e për të bërë kontrata të vlefshme me investitorët vendas, në rritjen e mundësisë së sipërmarrjeve për tu drejtuar në institucionet kredituese, me qëllim ndërmarrjen e aktiviteteve të fuqishme në fusha të ndryshme tregtare, prodhuese, të shërbimeve, etj, në uljen e mundësisë së “punës së zezë” dhe mos përfshirjes së punonjësve në skemën e sigurimeve sociale, në zhvillimin e konkurrencës së lirë, duke tentuar të minimizimin e konkurrencës së pandershme dhe ndërhyrjet e shtetit në këtë proces, në reduktimin e evazionit fiskal e për pasojë edhe të formave të korrupsionit, etj.

Ekonomia private shqiptare është e relativisht e re dhe si e tillë ka qenë e pashmangshme edhe prania e informalitetit në një pjesë të konsiderueshme të saj. Kjo i ka cfaqur efektet e saj në disa aspekte të ndryshme, por që në thelb konvergjojnë kryesisht në fenomenet e evazionit fiskal, punës së zezë dhe konkurrencës së pandershme. Zhvillimi dhe rritja e përmasave të këtyre fenomeneve cojnë domosdoshmërisht në dukuritë e korrupsionit, krimin të organizuar dhe në atë që në finale konsiderohet si “kapje e shtetit”.

Këta fenomene përbëjnë tërësinë e aktiviteteve që i shmangen detyrimeve ligjore për të paguar taksa, duke neglizhuar e anashkaluar respektimin e ligjit, në përpjekje të sigurimit të përfitimeve të paligjshme të menjëhershme në dëm të shoqërisë. Për pasojë shqetësimi publik rreth pasojave të kësaj ekonomie jo formale ka qenë dhe mbetet vazhdimisht prezent.

Faktor ndikues për rritjen e pjesës jo formale të ekonomisë konsiderohen edhe nivelet e larta të taksave, burokracitë e shumta administrative, mungesa e standarteve të plota të evidencimit e deklarimit transparent të veprimtarive ekonomike, etj.

Duke implementuar dhe zbatuar standartet e kontabilitetit, ne synojmë që krahas unifikimit të mbajtjes së kontabilitetit dhe përgatitjes së pasqyrave financiare, duke tentuar drejt standarteve ndërkombëtare, të ndikojmë në minimizimin e këtyre fenomeneve. Sfida për këtë qëllim do të përballohet nga të gjithë ne, profesionistët kontabilistë e auditues, organet shtetërore e të auditimit, drejtuesit dhe pronarët e sipërmarrjeve, etj.

Gjatë gjithë fazës së tranzicionit në Shqipëri, Ministria e Financave ka qenë mjaft aktive në hartimin e rregullave kontabile, të mishëruara në ligjet, vendimet apo udhëzimet përkatëse. Shumë prej nesh kujtojmë punën për hartimin e ligjit të parë për kontabilitetin në kushtet e ekonomisë së tregut, për hartimin e planit kontabël të përgjithshëm dhe sidomos për trajnimin dhe kualifikimin e një mase të gjërë profesionistësh të fushës së kontabilitetit. Falë kontributit të kësaj ministrie, të organizmave të profesionistëve kontabël dhe me asistencë të organizmave ndërkombëtarë janë rishikuar dhe azhornuar aktet ligjore dhe nënligjore të fushës. Ne kemi sot në zbatim një paketë ligjesh që rregullojnë kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare, auditimin ligjor të pasqyrave financiare, profesionet e kontabilistëve dhe të audituesve, të cilat krahas implementimit e zbatimit, janë vazhdimisht në vëmendje për të evidencuar mangësi apo gjëra të paqarta, me qëllim përafrimin apo përputhjen me direktivat e Komunitetit Europian në këto fusha.

Në kuadrin e programit ROSC (Report on the Observance of Standards & Codes), nën kujdesin e misionit të Bankës Botërore, Një Komitet Kombëtar i përbërë nga personalitete të fushës së kontabilitetit, financës, auditimit, mësimdhënjes në lëndët e fushës, etj, i ngaritur nga Ministria e Financave ka hartuar një plan strategjik për forcimin e kontabilitetit, i detajuar me fusha dhe faza konkrete, plan i cili është miratuar edhe nga Qeveria dhe është në proces realizimi, në varësi me burimet e nevojshme financiare. Pjesë e këtij plani, në kadrin e programit REPARIS, është në proces zbatimi i një marrëveshje me Bankën Botërore, financuar nga qeveria zviceriane, me një shumë prej rreth dy milion dollarë, i detajur në disa aspekte, kryesisht në drejtim të forcimit e përmirësimit të veprimtarive të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të Mbikqyrjes Publike të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar, të auditimit ligjor të pasqyrave financiare, të kurrikulavë universitare, etj.

Për sa i takon standardeve të kontabilitetit apo rregullimeve të tjera kontabile, Ministria e Financave ka qenë e gatshme për publikimin e tyre sa më të shpejtë, me qëllim bërjen të mundshme zbatimin në kohën e duhur.

Për mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sot janë të angazhuar me mijra profesionistë kontabilistë, të cilët janë ose jo të organizuar në organizata profesionale. Ne kemi të

rregulluar me ligj dy profesione me bazë kontabilitetin: Ekspert Kontabël i Regjistruar dhe Kontabilist i Miratuar. Ministria e Financave ka treguar dhe tregon një kujdes të vecantë për kualifikimin dhe certifikimin e këtyre profesionistëve, si dhe për mirë ushtrimin e profesioneve sipas fushave. Këtë kujdes dhe mbikqyrje Ministria e Financave e ushtron nëpërmjet autoriteteve të parashikuara nga ligji dhe që janë: Bordi i Mbikqyrjes Publike dhe Autoriteti i Certifikimit.

Bordi i Mbikqyrjes Publike, si organizëm i ri, i përbërë nga profesionistë ekspertë kontabël, shumica persona që nuk e ushtrojnë profesionin, është munduar që të realizojnë misionin e vet në drejtim të forcimit të mbikqyrjes publike të ekspertëve kontabël dhe të funksionimit të organizatave të ekspertëve kontabël e të kontabilistëve të miratuar. Synimi është forcimi i mëtejshëm i kësaj mbikqyrjeje në të gjitha fazat: trajnim, certifikim, ushtrim profesioni, kontroll cilësie, etj.

Autoriteti i Certifikimit, i përbërë nga personalitete të fushës, ka realizuar një volum të madh pune për finalizimin e dy sezoneve të certifikimit të eksperteve kontabel të regjistruar dhe të kontabilistëve të miratuar.

Rregullimet tona kontabile të deritanishme, kanë justifikuar deri në një farë mase qëllimin e tyre në funksion të përshtatjes me ekonominë e tregut, por evolimi i ekonomisë tonë me elementë të rinj, impenjimi i vendit në marrëveshje e konventa ndërkombëtare, evolimi i vetë standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit e të raportimit financiar, etj, bëjnë të pashmangshme dhe rishikimin dhe azhornimin e rregullimeve kontabile ekzistuese dhe përpunimin e standardeve gjithnjë e më të avancuara..

Zbatimi i standarteve të reja të kontabilitetit është e nevojshme të mbështetet edhe me zhvillimin e përmirësimin e legjisllacionit tjetër të interesuar, si ai fiskal, i parandalimit të pastrimit të parave, i sigurimeve shoqërore e marrëdhënjeve të punës, formulimi e implementimi i standarteve të kontabilitetit për sektorin publik, zhvillimi e forcimi i mëtejshëm i sistemit bankar, etj

E rëndësishme është që ne duhet të impenjohemi në këtë periudhë në një angazhim total të gjithë armatës së kontabilistëve, por edhe të audituesve për një njohje e përvetësim sa më të mirë të standardeve të kontabilitetit e të auditimit, për demonstrimin e një etike profesionale standarde, etj. Për këtë kërkohet kualifikim dhe rikualifikim i vazhdueshëm dhe këtu mendojmë se kontribues të rëndësishëm duhet të jenë organizatat profesionale të kontabilistëve dhe ekspertëve kontabël, departamentet e kontabilitetit në universitetet publike apo private, por edhe vetë Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. Ne konsiderojmë që edhe ky aktivitet i sotëm është një formë për të karikuar të gjithë aktorët dhe faktorët që lidhen me kontabilitetin dhe auditimin, për realizimin sa më mirë të detyrave dhe misionëve që ata kanë në këtë drejtim.

Ne shprehim bindjen se mbështetja dhe kontributet e Ministrisë së Financave për forcimin dhe përmirësimin e rregullave kontabile dhe të auditimit dhe për rregullimet e mbikqyrjes e profesioneve me bazë kontabilitetin në të ardhmen, ashtu si dhe deri tani, do të jenë prezentë.

Faleminderit.

PROF. DR. SOTIRAQ DHAMO
PRESIDENT I IKM
PËRGJEGJËS I DEPARTAMENTIT TE KONTABILITETI, FEUT

ROLI I ORGANIZATAVE PROFESIONALE NË ZHVILLIMIN E
PROFESIONIT KONTABËL

Roli i Organizmave Profesionale

Sigurimi i një informacioni financiar cilësor dhe të besueshëm në procesin e marrjes së vendimeve është e një rëndësie vendimtare në zhvillimin e ekonomik, social dhe financiar të një vendi. Kontabilistët dhe audituesit në pozicionin e tyre si hartues dhe vërtetues të këtij informacioni financiar ndodhen midis interesave të prodhuesve të informacionit financiar dhe të përdoruesve të tyre, investitorët, bankat, kreditorët, etj. Pra në këtë pozicion kontabilistët dhe audituesit kanë një rol publik shumë të rëndësishëm.

Profesioni kontabël është i rëndësishëm në jetën e një vendi, ai jep kontribut në zhvillimin ekonomik dhe në stabilitetin financiar, në funksionimin eficient të tregjeve të kapitalit dhe të sektorit publik. Profesioni i kontabilitetit nxit dhe mbështet rritjen dhe zhvillimin e biznesit në përgjithësi dhe sidomos të biznesit të vogël e të mesëm, duke iu dhënë atyre ndihmë në drejtimin strategjik e financiar dhe ka si objekt mbrojtjen e interesave të aksionarëve dhe të publikut që investon kapitalin në to.²

Gjatë procesit të zhvillimit të profesionit të kontabilitetit janë krijuar edhe organizmat profesionale të kontabilistëve, të cilat kanë si qëllim t'i shërbejë interesave të publikut³ duke siguruar zhvillimin e një profesioni të fortë dhe duke kontribuar në zhvillimin e një ekonomie të fortë e të qëndrueshme.

Për të luajtur këtë rol OP të kontabilitetit kanë si mision kryesor që t'i shërbejnë interesave të publikut nëpërmjet dhënies së kontributeve në zhvillimin e standardeve dhe udhëzimeve cilësore në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, në krijimin e kushteve për përshtatjen dhe zbatimin e këtyre standardeve, të kontribuojnë në zhvillimin e një profesioni të fortë të kontabilitetit dhe sigurimin e shërbimeve me cilësi të lartë nga profesionistët e kontabilitetit.

² Letër e drejtuar nga Ian Ball, Drejtori Ekzekutiv i IFAC, për Komisionin Europian, dhjetor 2010.

³ Sipas qëndrimit të IFAC, interesi i publikut i shërbehet më mirë kur ka një përshtatje dhe implementim të qëndrueshëm të standardeve me cilësi të lartë të pranuar ndërkombëtarisht të raportimit financiar, auditimit, të sigurisë, të kontabilitetit të sektorit publik, të edukimit kontabël dhe të standardeve etike (përfshirë dhe kërkesat e pavarësisë për audituesit) që përdoren në përgatitjen dhe paraqitjen e informacionit financiar. IFAC position 6 - Global regulatory convergence and the accounting profession, September 2012.

Deri në vitet 90 në Shqipëri nuk kishte profesion të kontabilitetit dhe as organizma profesionale. Pas viteve 90, pati një periudhë tranzitore në drejtim të zhvillimit të profesionit dhe të shërbimeve të kontabilitetit. Kjo periudhë karakterizohej nga zhvillimi spontan i shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit, të rregulluara këto me një kuadër rregullator në fillimet e veta. Shërbimet kryeshin nga kontabilistë individuale ende të paorganizuar. Me stabilizimin e ekonomisë së tregut filloi të rritej kërkesa për shërbimet e kontabilitetit dhe të auditimit dhe si pasojë edhe nevoja e zhvillimit të profesioneve të kontabilitetit dhe audituesit dhe e rregullimit të tyre. Fillimi i zhvillimit të organizmave profesionale konstatohet me krijimin e IEKA, me një akt ligjor dhe udhëzimet përkatëse në vitin 1998. Por ky rregullim plotësonte vetëm rregullimin e audituesve. Rregullimi i asaj kohe nuk parashikonte organizimin e detyrueshëm të kontabilistëve të miratuar. Ky organizim u bë mbi baza vullnetare, fillimisht në krijimin e një shoqate ku grumbulloheshin të gjithë ekonomistët, financierët, kontabilistët, studentët e kontabilitetit, në Shqipëri në vitin 1998. Por kërkesat e zhvillimit të profesionistëve të pavarur të kontabilistëve të miratuar bënë të nevojshme dhe krijimin e organizmit profesional që grumbullonte kontabilistët e miratuar në vitin 2000. Me kalimin e kohës roli i organizmave profesionale të kontabilitetit në Shqipëri ka ardhur gjithnjë duke u rritur.

OP luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin dhe mbrojtjen e interesave të anëtarëve të tyre si dhe në sigurimin e shërbimeve me cilësi të lartë. Zhvillimi i shërbimeve të kontabilitetit është një proces i rregulluar nga ligjet, udhëzimet dhe standardet. Në këtë proces është e përfshirë qeveria si dhe vetë organizmat profesionale. Rregullimi ligjor i shërbimeve të kontabilitetit dhe auditimit dhe zbatimi i standardeve përkatëse bëhet nga qeveria. Në këtë proces të hartimit të këtyre rregulimeve luan dhe duhet të luajnë një rol të madh edhe organizmat profesionale, si përfaqësuese të interesave të profesionit, të anëtarëve të tyre por edhe në shërbim të interesave të publikut.

OP kanë një rol të rëndësishëm duke bashkëpunuar me qeverinë për të siguruar që rregullimi i profesionit të kontabilitetit në nivel kombëtar të jetë efektiv, eficient dhe në mbrojtje të interesave të publikut. Zhvillimi i dialogut dhe i bashkëpunimit midis OP dhe qeverisë është thelbësor për të siguruar një ekuilibër të përshtatshëm midis vetë-rregullimit nga profesioni, vetë-rregullimit me mbikëqyrjen e publikut dhe përgjegjshmërisë dhe rregullimit të jashtëm.

Rregullimi i profesionit të kontabilitetit përfshin një sërë çështjesh si kërkesat për hyrje në profesion, për liçensimin dhe edukimin, monitorimin e sjelljes (etika) së kontabilistëve profesionistë dhe ndëshkimeve kur është rasti, hartimi i standardeve që duhet të zbatohen nga kontabilistët profesionistë.

Ashtu si dhe profesionet e tjera qëndrueshmëria dhe forca e profesionit të kontabilitetit varet nga cilësia e shërbimeve të kryera nga profesionistët dhe nga kapaciteti i profesionit për t'iu përgjigjur me efektivitet dhe eficiencë kërkesave të ekonomisë dhe shoqërisë. Rregullimi i profesionit synon pikërisht që të sigurojë një cilësi të lartë dhe qëndrueshmëri në cilësinë e shërbimeve të kontabilitetit. Roli i OP qëndron pikërisht në dy drejtime: *së pari*, në ndikimin për hartimin e një rregullimi të përshtatshëm të profesionit në bashkëpunim me qeveritë, dhe *së dyti* në sigurimin e zbatimit të këtij rregullimi dhe të shërbimeve cilësore në interes të publikut dhe në orientimin e kontabilistëve në ndryshimet e tregut.

Në kryerjen e shërbimeve të profesionit ndikojnë kostoja e shërbimit për përfituesin e saj si dhe përfitimet prej këtij shërbimi. Rregullimi i profesionit dhe OP duhet të sigurojnë një ekuilibër midis këtyre elementëve.

OP luajnë në rol nëpërmjet:

- 1- Vendosijs së kërkesave të cilësisë së shërbimeve dhe monitorimi i këtyre shërbimeve në përputhje me standardet;
- 2- Vendosijs së kërkesave të edukimit për hyrjen në profesion dhe për edukimin e vijueshëm profesional;
- 3- Vendosijs së kërkesave të etikës profesionale dhe e sistemit të ndëshkimeve;
- 4- Vendosijs së standardeve teknike dhe profesionale me cilësi të lartë.

Rregullatorët qeveritarë vendosin rregullimet por janë OP ato që sigurojnë zbatimin korrekt të këtyre rregullimeve, por jo vetëm. Në procesin e zbatimit të këtyre rregullimeve OP evidentojnë nevojat dhe kërkesat për përmirësimin, zhvillimin dhe hartimin e rregullimeve të reja që sigurojnë shërbimeve profesionale cilësore dhe në interes të publikut. OP të kontabilitetit duhet të realizojnë përgjegjësitë e tyre në lidhje me rregullimin e profesionit dhe kontabilitetit në mënyrë të tillë që të rritet efektiviteti i gjithë sistemit të këtij rregullimi. OP synojnë të sigurojnë cilësinë e shërbimit të anëtarëve të tyre nëpërmjet angazhimit në mbajtjen dhe promovimin e praktikave profesionale të një cilësie të lartë. Ato kanë edhe një rol që duhet të luajnë në zhvillimin e rregullimeve që prekin profesionin duke përfshirë edhe përgjegjësinë për të komunikuar dhe punuar me qeverinë në interes të publikut. Për këtë qëllim OP duhet të përdorë njohuritë e profesionit dhe të tregut ku operon që të ndihmojë qeverinë dhe organet e tjera rregullatorë të jashtëm për të hartuar dhe zbatuar një rregullim profesional me cilësi të lartë.

Ndikimi i organizmave profesionale shfaqet në disa drejtime si p.sh. në edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve auditues ose kontabilistë anëtarë të tyre, në hartimin e rregullimeve profesionale dhe të kontabilitetit, në rritjen e pavarësisë dhe integritetit të profesionistëve, në vendosjen e një etike profesionale, etj. Efekti përfundimtar i këtij ndikimi është sigurimi i informacionit të raportimit financiar të përgatitur apo audituar prej këtyre profesionistëve me cilësi dhe të besueshëm për përdoruesit, sigurimi i shërbimeve të tjera cilësore dhe të vlefshme për porositësit e tyre.

OP te kontabilitetit luajnë një rol të rëndësishëm në drejtim të konvergencës globale të rregullimit të kontabilitetit. Konvergjenca globale përfshin hartimin e standardeve me cilësi të larta të pranura ndërkombëtarisht dhe të hartuara nga organizmat ndërkombëtare të kontabilitetit, përshtatjen dhe zbatimin e qëndrueshëm të këtyre standardeve nga organizmat kombëtare, pra nga qeveritë, institucionet dhe organizmat rregullatorë, vendosjen e rregullimeve rregullatore që janë të qëndrueshme globalisht dhe që bazohen në kooperimin dhe njohjen e përbashkët. OP luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces duke ndikuar pranë qeverive për pranimin e standardeve të organizmit të tyre, të standardeve ndërkombëtare si dhe duke mbështetur anëtarët e tyre në njohjen dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare.

Roli i OP në Shqipëri

Gjatë periudhës pas viteve '90 roli i OP ka ardhur gjithnjë e në rritje. Ky rol shprehet në disa drejtime.

Në procesin e rregullimit ligjor të kontabilitetit. Ndërsa hartimi i ligjit “Për kontabilitetin” dhe të PKP të vitit 1993, është bërë tërësisht nga qeveria, sepse OP nuk ekzistonin, hartimi i ligjit të ri “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” që hyri në fuqi në vitin 2004, është bërë me një ndikim të ndjeshëm të OP. Pikërisht ky ligj i hapi rrugën edhe hartimit të SKK-ve në koherencë me SNK-të dhe pranimin e SNK-ve për një pjesë të njësive ekonomike me interes publik.

Në procesin e **hartimit të standardeve të kontabilitetit** në Shqipëri, proces ky i drejtuar nga KKK, konsultimi i OP dhe sugjerimet e tyre kanë qenë thelbësore në sigurimin e standardeve të kontabilitetit.

Po ashtu roli i OP në hartimin dhe implementimin e ligjit të ri për auditimin ligjor dhe profesionet e EKR dhe KM ka qenë i madh. Roli i OP vijon edhe gjatë procesit të zbatimit të këtij ligji.

OP në Shqipëri ndahen në: OP të rregulluara nga ligji dhe OP me vetë-rregullim ose më një rregullim të lehtë ligjor. Në grupin e parë të OP roli i OP përcaktohet gjerësisht në të gjitha fazat e zhvillimit të profesionit, të hyrjes, të licensimit, të edukimit, të kontrollit të cilësisë etj. Në grupin e dytë të OP roli i tyre vetë-rregullues është i madh. Pikërisht niveli i vetë-rregullimit të këtyre OP bën që edhe përgjegjshmëria dhe obligimet e OP për të siguruar shërbime cilësore dhe në interes të publikut të jetë më i madh.

Roli i OP në rregullimin e profesionit dhe të kontabilitetit është i madh si në rastin kur rregullimet përcaktohen në ligj dhe akte nënligjore nga qeveria ashtu edhe në rastin kur këto rregullime bëhen nga vetë organizmat profesionale. Ligji përcakton detyrimet e kontrollit të cilësisë për EKR, por zbatimi i tyre varet gjerësisht nga vetë OP i EKR. Ligji përcakton detyrimet e organizmave të KM për edukimin e vijueshëm, por mënyra, cilësia dhe llojet e këtyre edukimeve varet nga vetë OP.

Reputacioni i OP të kontabilitetit, pasqyron cilësinë e shërbimeve të kryera nga anëtarët e saj. OP mund të luajë një rol në rregullimin e profesionit për të siguruar cilësinë e shërbimeve të kryera nga anëtarët e saj. Në plotësimin e këtij roli OP kanë një përgjegjësi të madhe ndaj komunitetit ku ato jetojnë, për interesat e publikut, dhe jo vetëm për klientët apo punonjësit e tyre. OP organizojnë punën për të siguruar një proces që promovon shërbime me cilësi të lartë.

Në Shqipëri efektet e rolit të organizmave profesionale të kontabilitetit kanë qenë dhe janë evidente. Ky rol duket në rritjen e rolit të kontabilistëve në shoqëri, përmirësimin e cilësisë së informacionit financiar të publikuar nga shoqëritë shqiptare të çdo madhësie, në uljen e nivelit të evazionit tatimor masiv, në uljen e rasteve të sjelljeve abuzuese nga punonjësit e autoriteteve tatimore e doganore ndaj shoqërive, etj. Ky rol është i madh në procesin e rregullimeve kontabël dhe të auditimit por edhe në rregullimet e tjera që prekin fushat e mbuluara nga shërbimet e profesioneve të kontabilitetit. Ndikimi i organizmave profesionale ka qenë i madh edhe në rregullimet ligjore në fushën e shoqërive tregtare, të ligjeve tatimore dhe doganore, të

falimentimit të shoqërive, etj. Në këtë proces OP kanë bashkëpunuar me qeverinë, sa iu është krijuar mundësia, si dhe me shoqatat e biznesit.

Roli i OP shprehet në drejtim të :

1. Rregullimit ligjor të profesionit të mbuluar prej tyre;
OP kanë patur një rol aktiv në drejtim të hartimit dhe përmirësimit të ligjeve të profesionit. Mund të përmendet rregullimi i bërë IEKA në VKM dhe në ligjin e ri 10091 “Për auditimin ligjor, për profesionin e EKR dhe të KM”. Në këtë drejtim bashkëpunimi me qeverinë ka qenë efektiv dhe një proces diskutimi e shkëmbimi reciprok i mendimeve dhe ideve. Sidomos roli i MF dhe i ministrave Ruli, Malaj, Bode, ka qenë evident në mbështetje të këtij rregullimi në koherencë edhe me rregullimet ndërkombëtare dhe evropiane të kontabilitetit.
2. Hartimin e standardeve të kontabilitetit;
Nëpërmjet pjesëmarrësve në KKK nga ana e shoqatave, ndikimi i tyre në procesin e hartimit të Standardeve Kontabël ka qenë i vazhdueshëm.
3. Rregullimeve ligjore që prekin profesionin;
Mund të përmenden rregullimet në ligjet tatimore, doganore, tregtare, etj.
4. Në lidhje me edukimin në nivel universitar;
Roli i tyre ka qenë në bashkëpunimin me universitetet sidomos atyre publike, për të siguruar hartimin e curriculave universitare të përshtatshme për hyrjen në profesion;
5. Organizmit të kontabilistëve dhe audituesve për të rritur më tej cilësinë e shërbimeve të tyre dhe të rolit të tyre në jetën ekonomike.
Sot në Shqipëri ka disa organizma profesionale, si ato të EKR si dhe disa organizata të KM. Krijimi sidomos i OP të KM ka mundësuar rritjen e rolit të KM dhe në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të tyre. OP kanë hartuar një program të edukimit të vijueshëm të anëtareve të tyre, program të edukimit për hyrjen në profesion. IEKA dhe IKM kanë pranuar standardet e IFAC për SMO dhe kanë pranuar kodin e etikës së IFAC.

Konkluzione dhe rekomandime

1. Roli i OP është shumë i rëndësishëm për sigurimin e zhvillimit të shërbimeve cilësore dhe për shërbimin e interesave të publikut, duke ndikuar kështu në një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe një profesion të fortë të kontabilitetit.
2. Roli i OP duket në disa drejtime, nga të cilat do të përmendeshin ndikimi në procesin e rregullimit të profesionit në bashkëpunim me qeverinë, në procesin e hartimit të standardeve profesionale, në procesin e zbatimit të standardeve të profesionit, në procesin e përgatitjes së programeve të edukimit kontabël të përshtatshme dhe cilësore, në sigurimin e standardeve të etikës profesionale dhe të zbatimit të tyre në praktikë, etj.
3. Roli i OP në Shqipëri ka filluar pas vitit 1998 dhe ka ardhur gjithnjë e më shumë.
4. Roli i OP është i rëndësishëm edhe për vendosjen e lidhjeve ndërkombëtare me OP të vendeve të tjera, dhe për sigurimin e një konvergjence ndërkombëtare të rregullimit kontabël.
5. Për të rritur dhe përmirësuar rolin e OP në Shqipëri disa drejtime për t’u mbajtur në konsideratë në të ardhmen do të ishin si vijon:

1. Një bashkëpunim më i mirë dhe i qëndrueshëm midis OP me njëra tjetrën dhe me qeverinë.
2. Përfshirja më mirë e OP të KM në procesin e rregullimeve ligjore që po bëhen aktualisht. Kjo sepse aktualisht dallohet një mbivlerësim i IEKA dhe audituesve, ndërkohë kur numri i KM dhe i shërbimeve që ata kryejnë është më i madh dhe me ndikim evident.
3. Një bashkëpunim më i mirë dhe më gjithëpërfshirës i OP nga ana e MF dhe KKK dhe BMP. Ky bashkëpunim duhet të sigurojë që profesioni i kontabilistëve të vlerësohet më drejt dhe në mënyrë të barabartë.
4. OP duhet të punojnë më shumë në drejtim të kontrollit të cilësisë dhe të rregullimit të tyre të brendshëm. Kjo për të shmangur kontrollet e cilësisë formale dhe jo të plota, për të siguruar kryerjen e shërbimeve cilësore nga ana e anëtareve të tyre.
5. Të forcohet puna për zbatimin e kodit të etikës profesionale në praktikë.
6. Rritja e kapaciteteve institucionale të organizmave profesionale, hartimi dhe përmirësimi i rregulloreve, dhe udhëzimeve të tyre për kontrollin e cilësisë, për kodin e etikës dhe zbatimin e tij në praktikë.
7. Kërkohet përgatitja e programeve të kualifikimit për hyrjen në profesion cilësor dhe në nivelin që kërkon profesioni i kontabilistit aktualisht, duke forcuar për këtë qëllim dhe bashkëpunimin me organizmat e tjera profesionale, si dhe duke pasur parasysh standardet e edukimit profesional të IFAC.
8. Duhet të ketë një pjesëmarrje më të madhe nga ana e organizmave profesionale në drejtim të përgatitjes së komentarëve apo manualeve të kontabilitetit për fusha të veçanta, për sektorë të veçantë të ekonomisë, hartimin e udhëzuesve të ndryshëm profesionalë duke ndikuar kështu në sigurimin e kushteve për hartimin e rregullave cilësore të kontabilitetit dhe auditimit si dhe për një zbatim sa më të mirë dhe korrekt të këtyre rregullimeve nga kontabilistët dhe nga të gjitha palët e përfshira.
9. Duhet të ketë një bashkëpunim më të mirë institucional midis OP dhe fakulteteve ekonomike dhe organizmave të tjera rregullatore dhe mbikqyrëse.
10. Duhet një bashkëpunim më i mirë midis OP dhe BMP dhe Komitetit drejtues Kombëtar të Auditimit dhe Kontabilitetit.

Referencat

1. Profesioni i kontabilistit dhe Roli i organizmave profesionale, S. Dharmo, dhjetor 2011.
2. IFAC Policy position 6, september 2012, Global regulatory convergence and the accountancy profession
3. www.ifac.org
4. Financiar reporting: European Commission welcomes IASB/FASB convergence agreement, Eu commission press release
5. Ligji nr 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”.
6. Ligji “Për shoqëritë tregtare”, 1993.
7. Zhvillimet e ardhshme në fushën e Kontabilitetit, S.Dharmo- Buletini Ekonomik, 2006.

**NGA: PROF.AS.DR. AGIM BINAJ
PROF.DR.FLUTURA KALEMI**

NJËQIND VJET RAPORTIM FINANCIAR DHE EDUKIM, IDE DHE REFLEKSIONE

Abstrakt:

Në këtë 100 vjetor të themeleve të shtetit të ri modern Shqiptar, i cili lindi në Vlorë më 28 Nëntor 1912 nga një grup idealistësh dhe patriotësh shqiptar me Ismail Beun ne krye, ka vendin e vet edhe raportimi financiar, kontabiliteti dhe edukimi në këtë fushë.

Në këtë punim të shkurtër ne do të mundohemi të sjellim në vëmendje rrugën që ka përshkruar Kontabiliteti dhe raportimi financiar në këtë 100 vjetor. Kjo e lidhur edhe me rrugën që ka përshkruar edukimi në fushën e kontabilitetit.

Nevoja për kontabilitet dhe llogari u ndje që në ditët e para të shtetit të ri të sapo krijuar. Për këtë në AQ të shtetit ka urdhra dhe urdhëresa për organizimin e financave, të administrimit të buxhetit, të llogarive, të taksave etj.

Ashtu si edhe në fusha të tjera edhe në fushën e kontabilitetit dhe financave, apo të taksave, si fillim ishte eksperiencia turke. Kontabiliteti mbahej me defter (Libra) të sistemit të regjistrimit të dyfishtë. Kjo sepse shumë nga nënpunësit e Qeverisë së Vlorës vinin nga administrata turke. Më vonë më 1924 (Nëntor) nga Qeveria e Fan Nolit u hap në Vlorë shkolla e parë e kontabilitetit dhe tregëtisë - **Shkolla tregtare e Vlorës**. Kjo hodhi themelet e arsimit dhe edukimit në fushën e kontabilitetit. Më pas kontabiliteti pati zhvillime të reja si: Ligji i Kontabilitetit më 1929 nga Mbretëria e Zogut e deri në ditët e sotme ku kontabiliteti dhe edukimi njohën zhvillime të mëtejshme. Ato u ngritën në një shkallë më të lartë – implementimi i standardeve ndërkombëtare e kombëtare në përgatitjen e bilanceve dhe pasqyrave financiare, kurikulave të reja të kohës në arsimimin e lartë të profesionistëve të kontabilitetit, Auditimi si një mision i ri, etj.

Fjalë kyce: Në këtë 100 vjetor dhe më pas, kërkohen ide dhe refleksione për të çuar e sjellë ndryshime të reja në funksion të zhvillimit të praktikave të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar.

Duke analizuar 100 vjet Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Edukim, do ta ndajmë në 3 periudha historike.

- 1- Periudha e Parë 1912-1944
- 2- Periudha e Dytë 1944-1992
- 3- Periudha e Tretë 1992 e më pas

Këto periudha historike të zhvillimit të kontabilitetit, të raportimit financiar dhe të edukimit kanë vecoritë e veta, kanë arritjet dhe pengesat, kulmet dhe të tatëpjetat, por procesi ka ecur gjithnjë përpara.

I-Periudha e Parë nga viti 1912 deri më 1944.

Ne të gjithë e dimë se në strukturën e shtetit të ri modern shqiptar më 28 Nëntor 1912, ishte edhe struktura e financës, e kontabilitetit, e administrimit, e vjeljes së taksave etj.

Sigurisht që financat e Qeverisë së Ismail Beut ishin të vogla, të kufizuara për kohën. Megjithatë administrimi i tyre dhe informacioni kontabël u ndje si nevojë për kohën. Për këtë ka urdhëresa të posaçme të asaj kohe për vjeljen e taksave, administrimin, kontabilitetin etj. Sigurisht në fushën e financës dhe të kontabilitetit do të zbatohet eksperiencia turke – **Defteri** – (Libri), ku kontabiliteti mbahej në formë të regjistrimit të dyfishtë. Duhet thënë se edhe Turqia duke filluar nga shekulli i 18-të me specialistë francezë kishte futur sistemin e regjistrimit të dyfishtë. Kjo eksperincë njihej dhe nga shumë specialistë (financierë apo kontabilistë) shqiptarë që punonin në administratën e Perandorisë Turke. Si patriotë dhe idealistë, ata filluan ta zbatojnë atë eksperiencë edhe në administratën e Qeverisë së Ismail Beut, si punonjës të emëruar nga vetë ai.

1924 Nëntor Shkolla Tregtare e Vlorës. Kjo ishte një hap përpara për përgatitjen e kontabilistëve shqiptarë. Ishin këta kontabilistë të kësaj shkolle që do të mbanin mbi supet e tyre peshën e rëndë të kontabilitetit dhe raportimit financiar si në kohën e Mbretërisë ashtu edhe në vitet e para të diktaturës.

Në vitin 1929 e më pas Mbretëria e Zogut, kontabilitetit dhe raportimit financiar i dha rëndësinë dhe vendin e vet, duke nxjerrë të parin ligj shqiptar të kontabilitetit, i cili përmbante parimet dhe rregullat e mbajtjes së kontabilitetit në shtetin shqiptar të asaj kohe. Në këtë ligj vihej theksi në mbajtjen e kontabilitetit me parimet e regjistrimit të dyfishtë. Ky ligj ishte i pëparuar për kohën dhe solli përmirësime të dukshme në mbajtjen e kontabilitetit dhe raportimit financiar, qoftë në institucionet shtetërore qendrore, ashtu dhe ato lokale si edhe në njësitë e biznesit privat. Në arkivat e shtetit edhe sot gjen bilance të shtetit, të komunave, bashkive, bizneseve, shoqërive të huaja private si Italiane, Angleze etj., të cilat pasqyrojnë gjendjen financiare dhe pasurore të tyre. Të bie në sy që të gjitha dokumentet e raportimit financiar dhe bilancet janë pasqyruar me një shkrim të pastër dhe të qartë- vërtet kaligrafi **ekselente**.

II-Periudha e Dytë 1944-1992

Në këtë periudhë u bë centralizimi i ekonomisë që kërkonte dhe një ligj e plan kontabiliteti për të siguruar bilance dhe informacion kontabël në mënyrë të centralizuar, si shtet në tërësi por edhe për çdo ndërmarrje të vecantë (industriale, bujqësore, tregtare etj).

Për këtë doli plani kontabël nga Ministria e Financës më 1947 e më pas në 1965 pati disa ndryshime për t'u shkëputur nga influenca ruse, e më vonë në vitin 1979 disa ndryshime të tjera për të centralizuar më tej administrimin e ekonomisë dhe informacionit kontabël. Sipas dokumentave të asaj kohe për t'iu përgjigjur orientimeve të sistemit diktator, u përsos më tej evidenca e regjistrimit të dyfishtë e mjeteve kryesore, e investimeve, e shpenzimeve të prodhimit, e vlerave materiale etj.

Në këtë sistem të centralizuar, sistemi i raportimit me anë të bilancit, ishte i centralizuar, për çdo element pasuror raportimi i bëhej qeverisë së diktaturës. Gjatë kësaj periudhe, edukimi për ekonomistët e kontabilistët u ngrit në një shkallë më të lartë si në zgjerimin e shkollave të mesme të kontabilitetit, përveç asaj tregtare të Vlorës **që ishte fidanishtja e përgatitjes së kontabilistëve**, Teknikumi Ekonomik në Tiranë, etj.

U hapën edhe shkolla të larta, Fakulteti Ekonomik i Tiranës dhe Instituti Bujqësor i Tiranës. Në këto shkolla u përgatitën dhe u edukuan shumë kontabilistë të niveleve të larta, të cilët edhe në këto 20 vite në ekonominë e lirë të tregut, kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin një kontribut të çmuar në konsolidimin e kontabilitetit dhe raportimit financiar. Janë këta kontabilistë që me formimin e tyre profesional u përshtatën shpejt edhe me standartizimin e kontabilitetit edhe me hartimin e bilanceve dhe pasqyrave financiare si me Standardet Kombëtare dhe me ato Ndërkombëtare.

III-Periudha 1992 e më pas.

Në këto dy dekada edhe në fushën e kontabilitetit dhe të raportimit financiar u desh të bëhen ndryshime që t'i përgjigjeshin reformës në ekonominë e lirë të tregut. **Edhe raportimi financiar të decentralizohet.**

U punua në dy drejtime të rëndësishme:

- 1) Në drejtim të legjislacionit dhe,
- 2) Të përgatitjes së kapaciteteve për të zbatuar praktikën e reja që kërkonte koha.

Këto kushte përcaktuan dhe kërkesat për lindjen e profesioneve të lira si të Kontabilistit dhe Audituesit. Jemi dëshmitarë për legjislacionin në fushën e kontabilitetit, të vitit 1993 - Ligji i kontabilitetit në periudhën post komuniste; të vitit 2004 - Ligji i ri i Kontabilitetit vinte bazat për implementimin e standardeve të kontabilitetit; Ligji i vitit 2009 "Për auditimin dhe profesionin e Kontabilistit të Miratuar". Ky i fundit përveç të tjerave përcakton edhe rregullat e edukimit për të hyrë në profesion, organizimin e profesionistëve në organizma profesionale, rregullat e mbikqyrjes publike të profesionistëve, të kontrollit të cilësisë të edukimit në vijueshmëri të profesionistëve.

Në këtë periudhë si gjithë shoqëria shqiptare që ka pasur luhajtjet e veta në kërkim të më së mirës në kushtet e një shoqërie demokratike e të lirë tregu edhe kontabiliteti dhe rritja e kapaciteteve në këtë fushë, ka pasur ecurinë e vet në ngritje e përmirësim të vazhdueshëm. Përpjekjet për të rritur cilësinë e kapaciteteve në fushën e kontabilitetit kanë qenë në të gjitha hallkat. **Së pari**, në shkolla (të larta), hartimin e kurikulave, programeve mësimore, teksteve e mjeteve didaktike, etj. **Së dyti**, në organizatat profesionale të kontabilitetit dhe edukimit, ku janë hartuar dhe zbatuar programe të mira edukimi sidomos në fushën e standardeve si ato lokale dhe ndërkombëtare.

Mendoj se arritje sidomos në dy Universitetet e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe në Fakultetin Ekonomik, pjesë e kurikulave të kontabilitetit është bërë edhe teknologjia e informacionit kontabel (ATI), kjo e shoqëruar dhe me laboratorë kontabiliteti, ku studentet marrin njohuri të plota për Databazë – sisteme të fjalës së fundit të teknologjisë së informacionit kontabel të aplikuara në biznese konkrete. Edhe shoqatat profesionale si IEKA, Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë, Instituti i Kontabilistëve të Miratuar, etj., kanë dhënë dhe po japin në vijimësi ndihmesë për rritjen e cilësisë në formimin profesional të kontabilistëve. **Rezultatet e deri tanishme kanë qenë të kënaqshme, por jo të mjaftueshme për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje që kërkon koha.**

Duke u nisur nga përvoja pozitive në vendin tonë e të shumë vendeve të tjera si në drejtim të Raportimit financiar dhe edukimit, **gjykoj në këto 100 vite të tjera të shtetit modern shqiptar**, për të sjellë ndryshime në botën e kontabilitetit dhe në mjedisin shqiptar, për të ardhmen ka vend të bëjmë ndryshime të dukshme.

Se pari: Puna duhet të fillojë në formimin më mirë të kapaciteteve, që kontabilistët shqiptarë me kompetencë profesionale t'u bejne ballë **sfidave të kohës** duke u bërë të konkureshëm plotësisht me kolegët e tyre Europeanë. Kjo kërkon racionalitet dhe një qasje të re në përgatitjen e kontabilistëve duke lidhur që në shkollat e larta elementin teorik me atë praktik. Auditorët, laboratorët t'i kthejmë në qendra aplikative për lëndën e kontabilitetit, ku studentët të ndihen në **punë në një mjedis ndërmarrjeje. Atë punë aplikative që bënte Fultz-i i famshëm në Shkollat Teknike në Tiranë dhe në Golem Kavajë para 70 vjetësh. “Arën duke marrë plugun e punonte vetë, duke mësuar çdo student si të punojë tokën, jo teorikisht, por praktikisht”.** Unë mendoj se këtu ka vend të reflektojmë të gjithë, **për ta kthyer auditorin në një mjedis pune të vërtetë.** Për cilësi mësimdhënieje flasim çdo ditë, por ndryshe të flasësh dhe ndryshe të qëmtosh dhe të heqësh, të pastrosh të keqen e ta flakësh tutje, duke i hapur rrugën të mirës, kultivimit të mentalitetit të ri tek studentët, **atë të shpirtit të punës dhe të ndryshimit.**

Mendoj se në disa raste liria akademike pa kufi në shkollat e larta e dëmton cilësinë e mësimdhënies, por ajo mbulon edhe mësimdhënien e keqe duke i sjellë dëm të madh edukimit të brezit të kontabilistëve. Në një emision televiziv një analist këtë e quante **“kancer me metastaza të pashërueshme”** që po u lejua do të sjellë dëme të mëdha në shoqërinë shqiptare në shekullin 21.

Nga informacionet që kam reformimi i arsimit dhe rritja e cilësisë së tij po bëhet në çdo vend të botës problem i ditës, por sidomos në vendet perëndimore, p.sh. Gjermania po rishikon dhe reformon gjithë sistemin arsimor etj. për t'iu përgjigjur teknologjive të reja që po futen me shpejtësi në shekullin e ri.

Po ne çfarë duhet të ndryshojmë? Në përgjithësi flasim për ndryshime e cilësi në arsim e aq më tepër në disiplinat e kontabilitetit i cili ka marrë mbi shpatulla misionin e parandalimit të situatave të pakëndëshme. Unë mendoj se këtu ka vend të ulemi konkretisht se ku duhet të ndryshojmë e përmirësojmë. Mendoj se duhet filluar nga baza didaktike **sidomos Tekstet.** P.sh. bazat e kontabilitetit e disiplinat e tjera të **kontabilitetit a i nënshtrohen kritikës?** Shikoj që **teksteve të përkthyera u ndryshohet vetëm kapaku.** Njëherë kontabiliteti financiar, më pas bazat e kontabilitetit, më pas ai i avancuar e kështu me radhë dhe brendia është e njejta lëndë si më parë, me ndonjë ndryshim të vogël. **Mendoj se në këtë rast nuk mendohet për cilësi për vetësimi mësimi dhe formimi të kontabilistëve të ardhshëm, por për tregtë e fitime.** Dhe më tej të mendojmë seriozisht për për vetësimin e teknologjise së informacionit kontabel **me laboratorë modernë dhe me programe cilësore.** Mendoj se këtu s'ka vend për mendjemadhësi dhe vetëkënaqësi. Ne duhet të fusim në shkollën tonë të kontabilitetit përvoja më të mira të kësaj fushe, e jo të kënaqemi me atë të 10 vjetëve më parë. Pedagogu kurrë s'duhet të mbulohet me lirinë akademike, aq më tepër në Shqipëri që ka ende prapambetje e mungon kritika, por t'u referohemi fjalëve të **Cesllave Milloshit** Nobelistit Polak – **“Janë ende mendje të robëruara”.** Por nuk është kollaj **ta bësh të lirë një mendje të robëruar 50 vjet. Amaneti i Arbër Xhaferit i cili u nda nga jeta para do muajsh ishte: “Rugëtimi për emancipimin e Shqiptarëve është**

një maratonë dhe ne e dimë se jemi larg prej finishit”. Kjo do të thotë të punojmë çdo ditë aq më tepër ne përçuesit e dijës, të ndryshojmë vetë, pastaj të kërkojmë të ndryshojmë edhe studentët duke përcjellë tek ata mendimin e ri të kohës dhe të ndryshimit.

Se dyti, Teknologjitë e reja të informacionit të kontabilitetit duhet të paraprijnë formën e mendimit të ri të kontabilistëve dhe audituesve, që në një të ardhme të afërt kjo teknologji mund të çojë **edhe në braktisjen e kontabilizimit me hyrje të dyfishtë** sepse gjykohet që nuk është e nevojshme në procesimin e të dhënave kompjuterike. Teknologjia e informacionit kontabël mund të ndryshojë edhe natyrën e raportimit të jashtëm. Kjo sepse përdoruesit e jashtëm duke patur akses në bazën e të dhënave të njësisë së biznesit, manipulojnë të dhënat për të përmbushur nevojat e tyre të raportimit. Dhe raste manipulimi dhe mashtrimi në raportimin financiar po vërtetohen gjithandej. Mashtrime të tilla e kanë kaluar shifrën 650 miliard \$. Po Shqipëria ka mashtrime? Patjetër që ka dhe janë vërtetuar si ajo e **çështes Prifti** që ishte një spekulim i pastër për të evituar pagesën e taksave. Teknologjia e Informacionit Kontabël për ditë po gjen terren më të madh në vendimarrjet e biznesit. Kjo sepse:

- a) Aftësitë e fuqishme kërkuese që shoqërojnë paketat e bazës së të dhënave;
- b) Aftësia për të akomoduar pikëpamje të shumta të të njëjtit fenomen themelor në praktikat kontabile;
- c) Aftësia për të integruar të dhënat financiare dhe operacionale.

Në këtë këndvështrim profesionistët e kontabilitetit që në bankat e shkollës duhet të njihen mirë me bazën e të dhënave në mënyrë që ata të mund të marrin pjesë në zhvillimin e sistemeve të informacionit kontabël (SIK) edhe në sektorë të veçantë si bujqësia, ndërtimi, telekomunikacioni, prodhimi, mjedisi etj. Ata duhet të mësojnë që në bankat e shkollës dhe më pas të ndihmojnë duke siguruar që të përfshihen në kontrole të mjaftueshme për të mbrojtur të dhënat dhe për të siguruar besueshmërinë e informacionit kontabël.

Si ta arrijme? Mendoj se nga kampuset e Universiteteve të hiqen kafenetë, kazinotë, lojrat e fatit, që çdo natë janë mbushur me studentë. Kini mirësinë zoterinjtë të shkoni pas orës 6 të mbrëmjes dhe **në vend të qetësisë për studim të studentëve** do të dëgjoni muzikë të gjithfarë lloji etj.

Kjo situatë duhet të ndryshojë, në vend të kafeneve dhe sallave të lojrave të fatit dhe muzikës gjerrëseduke i pastruar të fusim mentalitetin e studimit tek studentet gjatë gjithë jetës. **“Njeriu duhet të mësojë çdo ditë sikur s’do të vdesë asnjëherë”**, sidomos në kontabilitet, duke krijuar sa më shumë biblioteka dixhitale, salla me kompjutera dhe internet, me databazë për kontabilitet, statistikë, menaxhim, matematikë, etj. Mendoj se kjo do të jetë një qasje e re me mentalitetin e studentit për të futurë shpirtin e punës dhe përvetësimit të të rejave të teknologjisë të shekullit 21.

Rekomandime.

- 1- Në këtë këndvështrim çdo institucion mësimdhënës dhe organizatë profesionale në kuadrin e këtij 100 vjetori, për 100 vitet e ardhshëm të analizojë punën e deritanishme dhe të ulet me laps në dore të ndryshojë duke hedhur poshtë ato mbeturina që na pengojnë në rrugën tonë të zhvillimit dhe krijimit të kapaciteteve në kontabilitet, të konkurueshme me Europën.

- 2- Ka ardhur koha që institucionet qeverisëse, ato edukuese dhe politikëbërsit e fushës së kontabilitetit në marrëveshje me njëri-tjetrin të hartojnë plane veprimi me qëllim implementimin e paketave të reja profesionale, sidomos në fushën e Teknologjisë së Informacionit Kontabel **me qëllim ngritjen e cilësisë në çdo hallkë.**
- 3- Edhe edukatorët e kontabilitetit duhet të kuptojnë më mirë kohën **“Koha s’ka më kohë për ne”**, qoftë edhe me programe shitesë të veçanta vetëm për pedagoget e kontabilitetit dhe financës, që këto disiplina të flasin **me një zë** në çdo universitet publik, por edhe privat duke trajtuar thellë dhe qartë arritjet e teknologjive të informacionit kontabel dhe këto t’i përcjellin sa më thjeshtë tek studentët e çdo niveli **në modulet e kontabilitetit, auditimit, financës** etj.

Profesorë te njohur në botë sot në reformën e edukimit në shkollat e larta theksojnë: **“ Me teorinë tonë të njohjes ne do të kërkojmë që studentët të deshirojnë të mesojnë, të dinë të mësojnë dhe çfarë të mësojnë.”**

Të nderuar pjesëmarrës!

Problemet e trajtuara nuk kane qëllim të mohojnë arritjet në fushën e kontabilitetit, ato tërheqin vetëm vëmendjen se ku janë pikat e dobëta **në shtëpinë tonë të kontabilitetit** dhe çfarë ide duhet të rrokim **për të ndryshuar më tej botën e profesionit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në Shqipëri.**

Ju Faleminderit!

Literatura

- 1- Accounting Ethica – viti 2008, Ronald F.Duska and Brend Shay Duska.
- 2- Accounting Information System – Marshall Romney and Paul Steinbart-2008
- 3- AQSH –dokumente te viteve 1912-1992 etj.

PROF. AS. DR. LINDITA LATI

ROLI I INFORMACIONIT KONTABËL PËR RITJEN E KONKURRUESHMËRISË

I nderuar Z. Kryetar I Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit Prof. Bollano,
Të nderuar kolegë e pjesëmarrës.

Ndihem e nderuar dhe e privilegjuar të jem pjesë e kësaj konference festive për 100 vjetorin e pavarësisë së kombit tonë, të organizuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit.

Krahas prezantimeve që fokusohen në aspektin historik të zhvillimit të kontabilitetit dhe rregullimit kontabël në Shqipëri si dhe punimeve të tjera që pasqyrojnë specifikat e këtyre zhvillimeve në kuadrin e sektorëve specifik, ky prezantim do të fokusohet në atë ç'ka duhet bërë më mirë nga pikëpamja e rregullimit apo zbatimit kontabël për një rritje më të qëndrueshme të ekonomisë së vendit.

Ky prezantim i trajton aspektet e informacionit kontabël nga pikëpamja e përdoruesit të këtij informacioni, dhe më konkretisht nga institucioni që garanton barazinë e lojës midis operatorve në treg. Pra, nëpërmjet këtij prezantimi synohet të argumentohet se si konkurrueshmëria e konkurrenca si pjesë e saj, si një nga elementët e rritjes ekonomike ndikohet nga vërtetësia e informacionit që japin pasqyrat financiare të njësive ekonomike që operojnë në tregun shqiptar.

Vitet e fundit gjithnjë e më tepër koncepti i konkurrueshmërisë është kthyer në një paradigme në zhvillimin ekonomik si për vendet e zhvilluara ashtu edhe për vendet në zhvillim. Koncepti i konkurrueshmërisë përfshin dhe vendos në vëmendje si kufizimet ashtu edhe sfidat që shtrou konkurrenca globale, marrja në konsideratë e ndikimit të kufizimeve buxhetore në reformat e ndërmarra nga qeveritë si dhe barrierat me të cilat ballafaqohet sektori privat duke konkurruar në tregun kombëtar dhe në atë ndërkombëtar.

Forumi Ekonomik Botëror (Ëorld Economic Forum) është institucioni ndërkombëtar që ka hartuar indeksin e konkurrueshmërisë si dhe mundëson matje të krahasueshme në mënyrë periodike duke mundësuar krahasimin e tij për të gjitha vendet e botës dhe paraqitjen e tij në Raportin Global të Konkurrueshmërisë (Global Competitiveness Report). Ky institucion ka definuar konkurrueshmërinë si *“një bashkim i faktorëve, politikave dhe institucioneve që përcaktojnë nivelin e produktivitetit të një vendi”*⁴

Termi i konkurrueshmërisë përdoret në një dimension më të gjërë si niveli i konkurrueshmërisë të një vendi, rajoni, apo qyteti. Për qëllimet e këtij prezantimi do të merret në konsideratë konkurrueshmëria nga pikepamja e njësive ekonomike, apo e firmës.

Në planin teorik dhe empirik është pranuar se konkurrueshmëria shpreh aftësinë e një njësie ekonomike për të përballuar konkurrencën në mënyrë të qëndrueshme. Në kushtet e një ekonomie gjithnjë e më globale, konkurrueshmëria gjithashtu bëhet globale dhe për rrjedhojë, njësitë ekonomike duhet të ballafaqohen si me konkurrencën në tregjet e brendshme ashtu edhe me tregjet ndërkombëtare. Qëndrueshmëria e konkurrueshmërisë është provuar se ka një korrelacion në një nivel të rëndësishëm me ambjentin konkurrues të vendit.

Gjithashtu, është e provuar teorikisht dhe nga të dhënat empirike se ka një korrelacion të qëndrueshme midis nivelit të konkurrencës, produktivitetit, konkurrueshmërisë dhe rritjes

⁴ Ëorld Economic Forum, [The Global Competitiveness Report 2009-2010](#), p. 3

ekonomike. Niveli i konkurrencës reflekton në mënyrë të drejtëpërdrejtë tek produktiviteti, si në përmirësimin teknik e teknologjik të prodhimit, ashtu edhe në nivelin e kulaifikimit të kapitalit human dhe organizimin e prodhimit.

Në kushtet e një ekonomie globale, njësitë e ekonomike të një vendi, pra edhe të Shqipërisë ballafaqohen me një presion në rritje të konkurrencës, si nga operatorët e tregjeve të vendit ashtu edhe nga operatorët e tregjeve ndërkombetare. Për të mundur rritjen e qëndrueshme të njësisë ekonomike në një treg konkurrues është shumë jetike zotërimi i një informacioni të plotë dhe të saktë financiare, informacioni i cili kryesisht sigurohet nga sistemet kontabël të informacionit.

Rregullimi kontabël u kthye në një debat i ditës, veçanërisht pas krizës ekonomike të viteve 1920-1930, e cila midis shumë aspekteve të tjera reformuese shtroi si domosdoshmeri diskutimin dhe pranimin e parimeve të kontabilitetit dhe i platformës së aplikimit të standarteve. Një nga qëllimet e sistemit kontabël është sigurimi i informacionit për palët e interesuara, të cilat kryesisht nuk kanë akses të plotë të informacioni kontabël i dosmodoshëm për vendimarrjet e tyre ekonomike. Në këtë mënyrë ata janë në disavantazh për të realizuar një vendimarrje sa më optimale dhe për të përdorur me efikasitet burimet e tyre, dhe ky disavantazh i madh është asimetria e informacionit që ata zotërojnë. Prandaj rregullimi shkon përtej përmbajtjes së informacionit kontabël, pra shtrihet deri tek hartuesit e raporteve që gjeneron sistemi kontabel i informacionit. Pra, rregullimi ka objekt të vetë edhe kompetencën profesionale të zotëruesve të profesionit të kontabilistit dhe të audituesit, të cilët duhet të jenë shumë të aftë që të mundësojnë paraqitjen e informacioneve financiare apo të mbikëqyrnin plotësimin e kushteve për një informacion të besueshëm, të drejtë e të vërtet.

Shumë autorë kanë analizuar rolin që ka luajtur kontabiliteti gjatë krizës dhe kanë bërë rekomandimet për të forcuar standartet e kontabilitetit si dhe për të konsoliduar procesin e implemetimit të tyre. Megjithatë kontabiliteti si sistem informacioni nuk është konsideruar si shkaktar i krizës financiare, në qendër të debateve kanë qënë përdorimi i disa masave të tilla si vlera e drejtë e tregut për të vlerësuar shkallën e likuiditetit të instrumentave financiare apo modelet e rivlerësimit të huave apo të borxheve në formën e letrave me vlerë etj. Pra duke iu adresuar përsëri aspekteve të rregullimit kontabël, theksohet rëndësia e përmirësimit dhe zbatimit të standardeve për përpiluesit e pasqyrave financiare, përdoruesve dhe rregullatorve, e cila është edhe një nga sfidat për këtë periudhë të zhvillimit të ekonomisë ndërkombëtare, por jo vetëm, Shqipëria nuk mund të përbejë kursesi përjashtim.

Gjithashtu, historitë e mashtrimeve dhe skandalet e ndodhura vitet e fundit me firmat e kontabilitetit si psh. rastet e Eron, Tyco, EorlCom, apo MCI, ri sollën në qendër të debatit rolin që kanë deformimet e raportimeve financiare në mirëfunksionimet e tregjeve jo vetem financiare por edhe më gjerë. Deformimi i informacionit të sistemit kontabël është konsideruar nga shumë autorë si shembulli klasik i dritëshkurtësisë apo si miopia e menaxherëve pasi duke rendur pas fitimeve afat-shkurta dëmtojnë vlerën e firmës në periudhat afat gjata. Mbi bazën e gjetjeve empirike si dhe të argumenteve teorike janë evidentuar efektet e tregjeve konkurruese për disiplinimin e menaxherëve kundër ndërhyrjes dhe manipulimit të informacionit kontabël të pasqyruar nëpërmjet pasqyrave financiare.

Është gjerësisht e pranuar se informacioni që gjeneron sistemi kontabël i informacionit mundëson ndërmarrjen e masave për rritjen e efikasitetit të transaksioneve, realizimin e marrëveshjeve të bashkimeve apo blerjeve, menaxhimin e cilësisë, zhvillimin e sistemeve të informacioneve dhe menaxhimin e tatimeve dhe taksave

Në këtë këndvështrim, është pothuajse fakt i pakundërshtueshëm se kontabiliteti në vetvete mund të konsiderohet edhe si një sistem në funksion të rregullatorit nëpërmjet: a) hartimit, zhvillimit dhe aplikimit të standardeve, të cilat duhet të jenë të kuptueshme dhe të detyrueshëm për t'u zbatuar, në interes të publikut për një informacion financiar cilësor, transparent dhe të krahasueshëm., si dhe b) promovimin e përdorimit dhe të aplikimit rigoroz të standardeve, për më tepër kthimi në një filozofi pune.

Natyrshëm shtrohet pyetja : A perben qëllim në vetvete hartimi dhe zbatimi i standardeve të kontabilitetit ?

Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë qartazi në Rregulloren e 2002 (paragrafi 2): informacioni i gjeneruar nga sistemi i informacionit kontabël është një instrument jetik për një funksionim sa më të mirë të tregut të brendshëm. Për më tepër, ky informacion luan një rol vendimtar për rritjen e efikasitetit të tregjeve të kapitalit dhe efikasitetin e përdorimit të inputeve. Por në një plan më të përgjithshëm con në uljen e kostove të transaksioneve, si elementi bazë i funksionimit të çdo njësie ekonomike.

Efektet e raportimit të “gabuar” dhe të deformuar kanë qënë objekt studimi i disa studjuesve të cilët kanë argumentuar se këto efekte janë shumë dimensionale dhe kanë efektin e reaksionit zinxhirë. Më konkretisht është argumentuar efekti zinxhir i cilësisë së pasqyrave financiare, si pasqyrim real i gjendjes pasurore të firmës, në aspektet e mëposhtme:

Eficienten e investimeve- nga pikëpamja e investitorit dhe nga pikëpamja e përzgjedhjes së projektit të duhur të investimit.

Asimetria e informacionit në tregje – problemin midis aksionerëve dhe menaxherëve.

Efektet zinxhirë jo vetëm në tregjet financiare si dhe në qëndrimin e kreditorëve.

Është gjerësisht e argumentuar se cilësia e raportimit financiar ka një efekt zinxhirë si dhe ndikon në vendimet mbi investimet e njësisë të tjera ekonomike. Kështu, menaxherët gjatë procesit të vendimarrjes për investime marrin në konsideratë pasqyrat financiare të njësisë të tjera ekonomike, apo përzgjedhin projektin e investimit që sjell normën më të lartë të fitimit. Në këtë mënyrë nëpërmjet pasqyrimit të deformuar dhe jo real të gjendjes pasurore në pasqyrat financiare, njësitë ekonomike japin sinjale mashtruese për njësitë e tjera ekonomike mbi alternativat e investimeve duke sjellë një ulje të efikasitetit të vendimeve për investime nga menaxherët. Nga ana tjetër, njësitë ekonomike që mashtron me të dhënat financiare mund të ketë një bum kerkesash për investime duke çuar në një deformim të kërkesës dhe ofertës nga pikëpamja e firmës, pra për rrjedhojë një proces të vendimeve për financime përtej kapaciteteve përthithëse të saj.

Gjithashtu, mashtrimi nëpërmjet pasqyrave financiare ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe tek motivimi i menaxherëve të firmave që mashtrojnë pasi treguesit e deformuar financiare shërbejnë për matjen e performancës së këtyre menaxherëve si dhe kompesimin e tyre mbi bazen e këtyre rezultateve. Marrja në konsideratë e një sistemi treguesish financiar të deformuar do të sjelli ndërtimin e një benchmark jo të vërtet dhe aspak motivues, mbi të cilin pronarët e njësisë ekonomike do të kërkojnë të masin dhe të kompesojnë financiarisht menaxherët e tyre, në përputhje me kontratat e menaxhimit.

Informacioni financiar i deformuar apo asimetrik ndikon në uljen e efikasitetit të përdorimit dhe të shpërndarjes së burimeve të firmës si dhe të investitorve. Ky fenomen ndodh kryesisht kur operatorët në treg nuk paraqesin në mënyrë besnike dhe të drejtë gjendjen e tyre financiare dhe pasurore nëpërmjet pasqyrave financiare duke shkaktuar në këtë mënyrë rritjen e kostos së transaksioneve, rënien e likuiditetit, si dhe ndikon në uljen e vlerës së firmës në treg.

Tregu dhe mirë funksionimi i tij është objekt i monitorimit dhe i mbikëqyrjes nga Autoriteti i Konkurrencës, i cili në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” mbron tregun nga praktikat antikonkurrese dhe loja jo e drejtë midis operatorve të tij. Në realizimin e misionit të tij ky institucion është një nga përdoruesit e informacionit financiar që gjenerohet nga sistemi i informacionit kontabël dhe që pasqyrohet në pasqyrat financiare, të cilat përdoren jo vetëm për të identifikuar sjelljen e firmave në treg por edhe për të kalkuluar gjrobat. Gjithashtu, institucioni i konkurrencës sipas rasteve që merr në shqyrtim disponon informacion të marrë nga Drejtoria e Përgjithëshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve apo nga institucione të tjera, dhe bazuar në analizat e ketyre informacioneve janë identifikuar rastet e mos barazimeve të levizjeve të vlerave në formë monetare apo në natyrë duke evidentuar qartazi deformimet dhe mos raportimin e drejtë financiare.

Në këtë këndvështrim institucioni i konkurrencës e shikon fenomenin e mashtrimit nëpërmjet raportimeve financiare si një faktor që shtrëmbëron konkurrencën e lirë dhe efektive në treg midis operatorve ku disa prej tyre përfitojnë lehtësira apo avantazhe në kurriz të operatorëve të tjerë duke e bërë lojën të pabarabartë midis tyre. Mbi të gjitha nga ky shtrëmbërim i realitetit dëmtohen gjerësisht konsumatorët si përfitues të drejtëpërdrejtë të një tregu konkurrues, nga njëra anë , apo si taksa pages nga ana tjetër.

Për këto arsye, Komisioni i konkurrencës gjithmonë ka mbajtur një qëndrim proaktiv duke kërkuar nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike të Profesionit vlerësimin e saktësisë së hartimit të pasqyrave financiare të atyre kompanive që janë gjykuar që nuk shprehin drejtë situatën pasurore të firmave, duke synuar në sensibilizimin e të mbikëqyrës të profesionit mbi detyrimin ligjor dhe moral të korrektesës së ushtrimit të profesionit.

Në këtë këndvështrim një punë akoma më intensive me organizatat ku aderojnë të licensuarit e profesionit të kontabilistit të miratuar dhe të ekspertit kontabël për rritjen e ndërgjegjësimit të tyre, për demin ekonomik dhe ndikimin që ka neglizhenca e tyre profesionale në mirë funksionimin e tregjeve si dhe në uljen e mirëqenies konsumatore, është konsideruar si një nga instrumentat që duhet të përdoret më shumë në të ardhmen.

Gjithashtu, rritja e forcës penalizuese nëpërmjet Bordit të Mbikëqyrjes së Profesionit, nëpërmjet një bashkepunimi më të ngushtë dhe intensive me Komisionin e Konkurrencës është kthyer tani në një domosdoshmëri.

Të nderuar Kolegë,

Profesioni i Kontabilistit është shumë jetik jo vetëm për firmen por për gjithë shoqërin, në këtë këndvështrim duhet të merrni në konsideratë se përfitimet që realizoni nga të ardhurat tuaj individuale e personale nuk arrijnë të kenë atë rezultat që do të kishin nëse tregu do të funksiononte në kushtet e një konkurrence reale. Prandaj ne jemi edhe faktor por edhe e pësojme nga një treg i deformuar , ku deformimi në pasqyrimet financiare kanë rolin e tyre.

PROF. AS. DR. HYSEN ÇELA

PERMIRESIMI RREGULLIMIT DHE MBIKEQYRJES SE PROFESIONIT TE AUDITUESIT - KONTRIBUON DREJTPERDREJT NE RITJEN E BESUESHMERISE SE RAPORTIMIT FINANCIAR.

Te nderuar pjesemarres,

Te dashur kolege,

Ne radhe te pare deshroj te falenderoj organizatoret e kesaj konference Jubilare, e posacerisht Prof. Jorgji Bollano, i cili ka treguar se vazhdimisht kujdeset per te sensibilizuar jo vetem profesionistet, por edhe te gjitha palet e tjera te interesit, ne lidhje me nevojen e permiresimit te cilësisë së raportimit financiar ne vendin tone.

Gjithmone eshte nder, vleresim dhe kenaqesi te flasesh ne eventet e Keshillit Kombetar te Kontabilitetit, ketij autoriteti qe i eshte perkushtuar dukshem permiresimit te metejshem te aspekteve rregullatore te raportimit financiar.

Sot eshte me shume evidente se kurre, se informacioni me i prekshem por edhe me i dobishem per te gjithë perdoruesit, duke nisur që nga aksioneret, punonjesit, menaxheret, klientet e furnoret, huadhenesit, qeveria, media, etj., e duke perfunduar tek publiku i gjere, eshte ai numerik qe jepet permes raporteve financiare te ndermjetme dhe atyre vjetore.

Cilesia e ketij informacioni qendron ne themel te marredhenieve qe vendosen midis paleve te interesuara dhe entiteteve te biznesit, te cilat ne analize te fundit kushtezojne ecjen, progresin, por edhe vazhdimesine ne kohe te këtyre të fundit.

Nisur nga ky kendveshtrim, une do te thoja se ka kohe qe roli i profesionisteve te fushes se kontabilitetit eshte ndryshuar duke kaluar nga nje rol thjesht pasiv i dhenies se informacioneve ne nje rol aktiv e menaxherial ne sherbim te permiresimit te sistemeve te menaxhimit dhe te qeverisjes se entiteteve te biznesit.

Ne kete rol te ri ndodhen sot edhe audituesit (ekspertet kontabel te autorizuar), roli i te cileve eshte themelor ne rritjen e besuesherise së informacioneve financiare historike. Ne shume juridiksione ku pothuaj detyrimet per rregullime te profesionisteve qe hartojne pasqyrat financiare (pra ku nuk ka rregullime per kontabilistet) mungojne, shkalla e besimit dhe e kerkeses ndaj audituesve ka prirjen te jete shume e larte. Ne disa juridiksione te tjera atyre ju eshte besuar jo vetem auditimi ligjor i pasqyrave financiare por edhe auditimi tatimor, ose ndryshe kontrolli tatimor per nje kategori te caktuar te entiteteve te biznesit.

Duke qene se ky rol i rritur i audituesve lidhet ne te njejten kohe edhe me nje pergjegjesi me te madhe ndaj atyre qe i perdorin keto informacione, zhvillimet e dekadës se fundit ne bote por padyshim edhe ne vendin tone, po e vene theksin gjithnje e me shume tek permiresimi i rregullimit, duke nxjerre ne plan te pare vendosjen e nje balance sa me efektive midis vetërregullimit dhe rregullimit te jashtem. Ligji SOX ne SHBA (2001) dhe direktiva e tete e BE-se (2006) dhe propozimet me te fundit ne nivel BE-se, kane rritur nevojën për rregullimin e jashtem te audituesit.

Sikurse çdo profesion tjetër edhe ai kontabël duhet t'i përgjigjet nevojave që shoqëria ka në një moment të caktuar të zhvillimit të saj. Kjo kërkon që nga njëra anë, profesionistët të zotërojnë njohuri dhe aftësi profesionale, të mbajnë qëndrime dhe të manifestojnë etikë e sjellje profesionale dhe nga ana tjetër, profesioni të jetë i rregulluar, pasi vetëm në këtë mënyrë

shoqëria dhe publiku i gjere do të garantohen se anëtarët e këtij profesioni do të prodhojnë rezultate të besueshme e të dobishme.

Historia shumë vjecare e zhvillimit të organizmave te profesioneve kontabël, lidhet me kërkesën e investitorëve publikë (furnizuesve të kapitalit) për të marrë informacione financiare mbi shoqëritë tregtare ku ata investonin kapitalet e tyre. Zhvillimi i profesionit dhe i shërbimeve të ofruara prej tij, sollen domosdoshmërinë e rregullimeve dhe të organizimit të anetareve te tyre në institucione qe garantonin qofte sigurinë ndaj publikut për shërbimet e kryera, ashtu edhe mbrojtjen e vete profesionisteve.

Nevoja e rregullimit diktohet nga fakti qe **tregu i shërbimeve kontabël** eshte jo eficient, pasi:

(i) se pari në marrëdhëniet klient profesionist kontabël ekziston një lloj asimetrie informacioni, e cila shprehet në faktin që klienti i cili merr shërbimin kontabël, nga njëra anë ndodhet në një pozitë më inferiore, pasi përgjithësisht ka më pak njohuri se profesionisti që jep këtë shërbim, dhe nga ana tjetër, ai nuk ka asnjë rrugë tjetër përveçse të mbështetet në shërbimet e profesionistit.

(ii) se dyti si rregull, përfitimet apo kostot e shërbimit kontabël kalojnë direkt tek palët e treta, të cilat mund të mos jenë kërkuesit e këtyre shërbimeve (informacionet financiare të publikuara).

Teorikisht rregullimi i profesionit mund te realizohet nepermjet disa rrugeve te cilat nisin me rregullimin spontan permes mekanizmave te tregut - permes raportit kerkese oferte; rruga e dyte eshte ajo veterregullatore ku profesioni rregullohet vete dhe vendos mekanizma qe e bejne ate te jete i besueshem per publikun; dhe rruga e trete eshte rregullimi nga autoritetet shtetetore ose autoritete te tjera te pavarura.

Ne praktike, eshte pothuaj e pamundur qe njera nga rruget e mesiperne te perdoret apo te funksionojë e shkeputur nga rruga tjetër, ndonese raporti midis veterregullimit dhe rregullimit ka qene i ndryshem ne kohe dhe vende te ndryshme. Sidoqoftë praktika e sotme e shume vendeve tregon per nje kombinim midis veterregullimit dhe rregullimit te jashtem, nje sistem i cili ndodhet ne nje proces ndryshimi permanent.

Ndryshe nga shtetet me ekonomi të zhvilluar ku zhvillimi profesional ka ardhur natyrshëm bazuar në nevojën që kishin palët e interesuara për informacione financiare transparente, në vendin tonë dhe pothuaj në shumicën e vendeve të tjera të Europes Lindore, ngritja dhe zhvillimi profesional ishin më shumë të orientuara nga domosdoshmëria e funksionimit normal të ekonomisë së tregut dhe deri diku, kanë qënë edhe të imponuara nga legjislacionet kombetare. Performanca dhe cilësia e shërbimeve të profesionit kontabël kane ndikim te madh në përfitimin ekonomik dhe shoqëror, per faktin qe profesionistët kontabel kontribuojnë si ne alokimin dhe menaxhimin eficient të burimeve publike e private, ashtu edhe në përmirësimin e funksionimit të tregjeve financiare dhe të kapitalit dhe të tregjeve të prodhimit të mallrave e shërbimeve.

Globalizimi, kjo tendence zhvillimore e sotme, ka rritur nevojen per te perafruar jo vetem gjuhen e raportimit te informacioneve financiare historike, me qellim qe ato te perdoren nga nje numer gjithnje e me i ndryshem palesh te interesuara, por gjithashtu ka rritur nevojen e standardizimit edhe ne rregullimin e profesioneve, duke e kaluar balancen e rregullimit te profesionit ne rregullimin publik kundrejt veterregullimit.

Modeli aktual i organizimit të IEKA, duket se është më afër zhvillimeve ndërkombëtare, e posaçërisht më afër kërkesave të direktivës së 8-të të BE-së të datës 17 maj 2006 (Directive 2006/43/EC). Rregullimi i ekspertit kontabël të regjistruar (audituesit ligjor) dhe i organizmit të tij profesional ka në thelb një kombinim midis rregullimit nga jashtë dhe vetërregullimit. Sipas kuadrit aktual ligjor dhe rregullator (ligji 10091 3/09), krahas organizmit profesional, eshte

krijuar dhe funksionon Bordi i Mbikeqyrjes Publike, i cili ka jo vetem rol mbikeqyres, por deri diku edhe rregullator.

Rishikimi dhe forcimi institucional i profesionit te audituesit është bërë më imperativ sidomos në momentet më kritike të historisë së zhvillimit ekonomik, e vecanerisht në rastet e krizave ekonomike dhe në momentet e falimentimit të korporatave të mëdha. Kohet e fundit, roli i profesionit kontabël ka pësuar zhvillime të mëtejshme duke u orientuar gjithnjë e më shumë në standarde profesionale cilësisht të larta, dhe sidomos në kërkesat etike dhe të sjelljes së duhur profesionale.

Në dekadën e fundit kanë ndodhur ndryshime të thella, te atilla që nuk ishin pare qe nga koha e krizes se viteve 29-33. Mjafton te permendim Ligjin SOX ne SHBA (2001), Direktiven e tete te BE-se (2006), por edhe propozimet me te fundit te Komisionit European, apo edhe ndryshimet legjislative ne shume vende dhe krijimin e autoriteteve te mbikeqyrjes se profesionit, per te kuptuar tendencen e mbikeqyrjes, inspektimit e monitorimit ne funksion te nje qëllimi të vetem, ate te garantimit te cilesise se auditimit ne sherbim te rritjes se besueshmerise të palëve të interesuara në informacionet financiare historike.

Kriza globale financiare e cila nisi si kriza e korporatave, e pasuar nga kriza e bankave, per te vijuar me krizen e borxheve sovrane te shteteve, ndonese ende nuk është analizuar plotesisht persa i perket shkaqeve, nuk ka lene pa fajesuar as audituesit. Ështe kjo krize që ka nxjerre ne pah nevojten për përmirësim dhe rikonsiderim të rolit të audituesit duke e pare ate ne disa plane-sic jane rritja e cilesise se punes audituese, zgjerimi i fusheveprimit te auditimit dhe forcimi i mbikeqyrjes së jashtëme.

Në këtë kuadër, kohet e fundit Komisioni European beri disa propozime sa i takon auditimit të enetiteteve me interes publik, ku perfshihen rotacioni i detyrueshem i audituesve, ndalimi i dhenies se sherbimeve te jo auditimit tek klientet e auditimit, tenderimi i auditimeve, etj.. Megjithate, Parlamenti European nuk i konsideroi per faktin që arsyetimet e dhena nuk ishin shume bindese dhe se ato shoqëroheshin me kosto shtese.

Eshte e natyrshme që edhe ne te ndjekim keto zhvillime, me qellim që te mos mbetemi prapa sa i takon adoptimit te legjislacionit komunitar, ndonese duhet thene se tek ne me shume ekziston prirja per te bërë rregullime më shumë nga sa na nevojiten duke u kujdesur pak ose aspak për implementimin në praktike.

Sic e theksova edhe me siper ajo qe une mendoj se ne duhet te bejme aktualisht eshte te punojme per te rritur rolin e audituesit duke kontribuar ne bërjen të njohur te ketij funksioni të rendesishem jo vetem per palet e jashteme por edhe per palet brenda entitetit. Se cfare ben audituesi, ose cfare duhet te beje audituesi, pothuaj nuk njihet sa duhet nga pronaret, menaxheret apo punonjesit, e theksuar kjo sidomos auditohen SME-te. Ne praktike auditimi konsiderohet me shume si nje detyrim apo barre ligjore dhe ne kete kuptim audituesit i kerkohet vetem raporti standard thjesht “per te qene ne rregull” me autoritetet.

Perpara se te punojme per te forcuar me tej mbikeqyrjen e audituesit, une mendoj se eshte e nevojshme te vendosim nje dialog permanent midis organizmit profesional dhe paleve te interesuara, te informojme përfituesit e drejtperdrejte dhe te terthorte te auditimit, me qëllim që ata te kontribojne në përdorimin eficient te ketij funksioni te rendesishem.

Një hap tjetër i rendesishem mendoj se do te ishte zgjerimi i fushes se veprimit te auditimit duke i kerkuar audituesit te kontribojne me sherbime shtese, sic mund te ishin vleresimi dhe raportimi mbi kontrollin e brendshem, mbi rreziqet e biznesit, e keshtu me radhe.

Në kuadrin e programit të vet të thjeshtimit dhe standardizimit të auditimit dhe sidomos të zbatimit proporcional të SNA-ve IEKA se shpejti do të nise një dialog me biznesin dhe autoritetet me qëllim rritjen e ndergjegjesimit të tyre dhe të perfitimeve që vijnë nga auditimi. Në përfundim të kësaj paraqitje shpreh mendimin se në pjesën rregullatore ekzistuese të profesionit të e.k.r-së, ka nevojë të përmirësohet, të rikonsiderohet e të harmonizohet me mirë çështja e mbikëqyrjes publike të profesionit, duke përfshirë të gjithë aktorët. Për këtë qëllim mendoj se merr rëndësi bërja e një analize të thellë krahasuese nga pikëpamja e dobishmërisë (kosto përfitim) e cila duhet të mbajë mirë parasysh gjendjen e entiteteve të biznesit tek në e sidomos shoqëritë tregtare me interes të madh publik, i cili nuk është shumë i konsiderueshëm dhe bursa pothuaj nuk funksionon.

Hysen ÇELA
Kryetar i Këshillit Drejtues IEKA

PROF. AS.DR. ORFEA DHUCI
ALPHA BANK ALBANIA

**SFIDAT QË U TEJKALUAN DHE ATO QË PRITEN NGA BANKAT NË
ZBATIMIN E SNRF-VE**

Kalimi nga standardet lokale të kontabilitetit në standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) për bankat dhe institucionet e tjera financiare ka qenë një nga sfidat më të mëdha për bankat që operojnë në vendin tonë për dy arsye kryesore.

- a) Bankat dhe institucionet e tjera financiare do të ishin të parat që do të përballeshin me zbatimin e standardeve të reja. Kjo buronte nga ligji por edhe nga kërkesat ndaj bankave mëmë në vende të ndryshme evropiane për konsolidimin e pasqyrave financiare të grupeve bankare përkatëse.
- b) Bankave dhe institucioneve të tjera financiare do t'u duhej të zbatonin standardet ndërkombëtare të raportimit financiar në kushtet e përhapjes së shpejtë të krizës së përgjithshme financiare që preku gjithë vendet pavarësisht nga shkalla e prekjës.

Duke marrë në konsideratë:

- a) që shumë vende kaluan në SNRF në vitin 2005,
- b) që disa vende si Kanada, Kore e Jugut dhe Meksikë kaluan në zbatimin e SNRF në vite 2011 dhe 2012,
- c) duke marrë në konsideratë debatet pa fund që zhvillohen ende edhe sot në SHBA për dobishmërinë e kalimit në IFRS, dhe
- d) duke parë diskutimet e pafundme për zbatimin e IFRS-ve (që nga zbatimi i IFRS-ve në Evropë dhe Australi vetëm në internet gjenden mbi 800,000 artikuj, komente, etj)

duhet të thuhet se sfida e zbatimit të SNRF në Shqipëri dhe veçanërisht zbatimi i tyre në industrinë bankare, u përballua dhe u tejkalua me sukses të plotë. Shqipëria, sot mund të mburret që një pjesë e madhe e shoqërive të saj tregtare janë të afta të raportojnë sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar. Megjithë skepticizmin fillestar, sot duhet të pranojmë se grupet e punës për hartimin e ligjit për kontabilitetin dhe raportimin financiar ishin “largpamës” dhe “me këmbë në tokë”. Gjithashtu ata që punuan për përkthimin e standardeve dhe me siguri Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të lavdërohen duke e renditur vendin tonë në vendet që njohin dhe zbatojnë standardet ndërkombëtare të pranuarra gjerësisht.

Por, rruga drejt zbatimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar nuk ishte një rrugë e hapur dhe pa pengesa. Mungesa e eksperiencës dhe mosmarrja pjesë në diskutimet e gjera të organizuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare, si edhe mospërkthimi i tyre në gjuhën shqipe, do të ekspozonte bankat dhe institucionet tona financiare para sfidave të shumta që do t'i grupoja në dy grupe:

- a) sfida dhe vështirësi në kuptimin e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.
- b) sfida dhe vështirësi në zgjidhjen e trilemës “Plani i llogarive, sistemi informatik i Librit të madh dhe sistemet informatike të raportimit”.

1. Pesë sfidat më kryesore në kuptimin e SNRF-ve

Fillimisht kalimi nga standardet ekzistuese në standardet ndërkombëtare të raportimit financiar është shoqëruar me shumë moskuptime e me shumë keqinterpretime. Ende edhe sot ka mjaft të

tilla. Unë do të trajtoj pesë (sa gishtat e dorës) që janë konsideruar nga bankat shqiptare para se të fillonte zbatimi i SNRF si më të rëndësishme.

1. Instrumentet financiare, klasifikimi, matja njohja dhe çregjistrimi

Megjithë përpjekjet e mëdha të bëra që më parë me Manualin e Kontabilitetit Bankar, bankat u ndeshën me problemin e konceptimit të klasifikimit, matjes, njohjes dhe çregjistrimit të instrumenteve financiare.

Vështirësia nuk qëndroi aq në klasifikimin e instrumenteve financiare por në radhë të parë në matjen e tyre. Ndërkohë që zbatimi i SNRF-ve përkoi me zhvillime të reja, bankat u “mbushën” me likuiditet dhe filluan të investojnë më shumë në letra të ndryshme me vlerë brenda dhe jashtë vendit. Konceptet e reja të *vlerës së drejtë* dhe të *kostos së amortizuar* për instrumentet financiare dhe përdorimi i tyre praktik ishte një shqetësim shumë i madh për të gjithë bankat. Vështirësia e zbatimit u shtua edhe për shkak të diskutimeve shumë të gjera për shkak se në Nëntor 2009 dhe Tetor 2010, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare nxorri pjesët e para të një standardi të ri, të Standardit 9 “Instrumente financiare”, të cilat megjithëse sqaruan shumë anë të errëta që linin Standardet e Kontabilitetit 32 dhe 39, për shkak të kohës (kujtojmë që zbatimi i SNRF-ve përkoi me krizën globale financiare) u pritën me mosbesim dhe bankat u çorjantuan fillimisht.

Megjithatë sot mund të mburemi bankat shqiptare për shkak të mospasjes në portofolet e tyre të aktiveve problematike i implementuan me sukses këto standarde.

2. Përqësimi i instrumenteve financiare

Megjithëse teorikisht teknikat e matjes dhe të vlerësimit të përqësimit të aktiveve financiare u kuptuan shumë mirë, zbatimi në praktikë ndeshi në një sërë përplasjesh me autoritetet rregulluese bankare e financiare dhe autoritetet tatimore. Tatimet shpejtuan të njohin si shpenzime të zbritshme vlerat e përqësuar të aktiveve por mbasi të ishin bërë të gjithë përpjekjet ligjore ndërkohë që autoritetet rregulluese vrapuan të flasin për fshirje aktivesh edhe pa u kompletuar këto përpjekje duke e lënë edhe sot problemin të pazgjidhur. Nga ana tjetër mungesa e serive kohore afatgjata për humbjet nga huatë (kujtoni që para 2008 humbjet nga huatë ishin një përjashtim) ka bërë që probabiliteti i dështimit për vlerësimet kolektive të mos përfaqësojë realisht probabilitetin e dështimit por norma administrative të vendosura nga bankat mëmë mbi bazën e eksperiencës së tyre ose të bankave të tjera. Por edhe në vlerësimin individual vihet re ende dhe sot subjektivizëm në parashikimin e rrjedhave monetare, vlerës së kolateraleve, normave të qethjes dhe normave të zbritjes duke nxjerrë në pah që ende procesi dhe standardet përkatëse në lidhje me përqësimin e aktiveve duhet të rishikohen dhe të përmirësohen.

3. Kontabiliteti i kundërpozicionimeve

Kontabiliteti i kundërpozicionimeve është kontabiliteti që pasqyron përpjekjet e bankave për të minimizuar luhatshmërinë e fitimeve apo humbjeve që lindin nga fluturakësia e kurseve të këmbimit, normave të interesit apo i ndryshimeve në vlerën e drejtë të instrumenteve financiare. Bankat kanë qenë shumë të shqetësuar për implementimin e kontabilitetit të kundërpozicionimeve të paktën për kundërpozicionimet: për rrjedhat monetare, për normat e interesit për luhatjet e vlerës së drejtë, dhe për monedhat e huaja.

Kontabiliteti i kundërpozicionimeve është detajuar dhe parashkruar (preskriptiv). Si i tillë ai kërkon kujdes të veçantë që marrëdhëniet e kundërpozicionimeve të identifikoohen në një mënyre të tillë që të plotësohet standardi dhe në veçanti kërkon që testet e efektivitetit të hartohen në një mënyre të tillë që kërkojnë minimizimin e riskut të dështimit të kundërpozicioneve të ardhshme.

Pavarësisht se standardet përkatëse për kontabilitetin e kundërpozicionimeve ishte parashkruar domethënë detyrues, bankat arritën t'i zbatonin këto standarde me sukses që në fillim dhe sot ato kanë ngritur në përputhje të plotë me SNRF, kontabilitetin dhe raportimin e transaksioneve me të gjithë llojet e rrjedhimoreve që tregtohen në Shqipëri dhe në tregjet ndërkombëtare.

4. Paraqitja e pasqyrave financiare dhe raportimi për publikun e gjerë të instrumenteve financiarë

Forma e pasqyrave financiare nuk është preskriptive (parashkruese). Kjo do të thotë se bankat duhet të përgatiteshin për të ndërtuar formatet e tyre të pasqyrave financiare sipas nevojave të grupeve të ndryshme të interesit. Natyrisht ky do të ishte një projekt i gjatë sepse nën presionin e grupeve të interesit bankat që operonin në Shqipëri duhet të nxirnin raporte financiare sa më të kuptueshme, të besueshme dhe disi të krahasueshme me pasqyrat financiare të njëra-tjetrës. Nga ana tjetër edhe shënimet për pasqyrat financiare duhet të ishin të detajuara, të kuptueshme e të besueshme për gjithë publikun.

5. Zbatimi për herë të parë i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit


Zbatimi për herë të parë i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar është shoqëruar me pikëpyetje të mëdha si nga bankat ashtu edhe nga grupet e interesit. Bankat ishin shumë të shqetësuara për mënyrën se si do të pasqyroheshin rezultatet ekonomiko-financiare jo vetëm të vitit që standardet hynin në fuqi por edhe të vitit të mëparshëm, cilat do të ishin efektet e ndryshimit të politikave të raportimit financiar tek investitorët, kreditorët, (depozituesit) ashtu edhe organet tatimore. Grupet e interesit ishin të shqetësuara nëse do t'i kuptonin apo jo ndryshimet kontabile dhe format e paraqitjes së pasqyrave financiare të bankave.

Sot mund të themi se të dy palët si bankat ashtu edhe grupet e interesit me një ndjenjë të lartë ndërgjegjshmërie dhe bashkëpunimi arritën të kuptonin njëri-tjetrin dhe me një mirëkuptim të lavdërueshëm të arrinin të korigjonin aspekte të veçantë të raportimit në një kohë tepër të shkurtër. Por kjo nuk ndodhi me autoritetet fiskale. Ende dhe sot palët ndajnë mendime të ndryshme që burojnë nga mosbesimi dhe mungesa e ndërsjellësisë. Por është për t'u lavdëruar Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Megjithë që bankat nuk e besonin, pranimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar për këtë qendër është i padiskutueshëm, shifrat dhe pasqyrat e vëna në dispozicion nga bankat të besueshme dhe të sakta. Shtesat e kapitalit, emetimi i borxheve të nënrenditura, që bazohen në standardet ndërkombëtare janë mëse të pranueshme nga QKR duke prezantuar kështu një nga institucionet më përparimtare në këtë drejtim.

2. Plani i llogarive, sistemi informatik i Librit të madh dhe sistemet informatike të raportimit

Të gjithë raportet financiare të bankave, si ato për nevoja të brendshme të drejtimit ashtu edhe ato për nevoja të raportimit për publikun e gjerë dhe për autoritetet rregulluese të veprimtarisë bankare dhe financiare, bazohen kryesisht në dy “instrumente” kontabël: në Librin e madh dhe në Planin e llogarive të bankës.

Figura 2.1 Sistemet e informacionit dhe ushqyerja nga njëri-tjetri



Gjithashtu si edhe çdo ent tjetër, bankat janë të detyruara të përdorin sisteme informatike për Ditarin dhe Librin e Madh, sisteme të cilët ushqehen dhe njëkohësisht ushqejnë sisteme të tjera të ndryshme: sisteme burimore (Source Systems); sisteme për transaksionet (Front-end Applications); Magazina të dhënash (Data Warehouse) Sisteme për Raportime etj. Në një paraqitje grafike marrëdhëniet ndërmjet tyre do të ishin:

Konvertimi i raportimit financiar sipas standardeve ekzistuese në raportimin financiar sipas SNRF-ve ndërmjet koncepteve, parimeve e kërkesave të reja kërkonte edhe ndryshime serioze në kapjen, analizimin dhe paraqitjen e të dhënave të reja sipas kërkesave të tyre, gjë që kërkonte përshtatje dhe zhvillimin e sistemeve informatike që kapin, e përpunojnë të dhënat e transaksioneve. Për më shumë, konvertimi kërkonte një zgjedhje që do t'i qëndronte kohës në lidhje me Planin kontabël, me Librin e madh dhe me sistemet informatike të tyre.

Për të gjitha bankat ishte e qartë se të paktën raportimi financiar do të ishte një raportim dyjarës për një kohë shumë të gjatë: bankat do të raportonin edhe sipas SNRF (të diktuar nga kërkesat ligjore për raportimin sipas SNRF-ve) por edhe sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë


(pasqyra financiare si pjesë e sistemit të raportimit të unifikuar mbi bazën e një plani kontabël të miratuar për bankat).

Pikërisht ky raportim dyjarës do të shtronte përpara bankave trilemën e Librit të madh pra edhe të Planit të llogarive kontabël, që do të përdorej:

- a) një plan llogarish në përputhje dhe në shërbim të raportimit financiar sipas standardeve lokale,
- b) një plan llogarish në përputhje dhe në shërbim të raportimit financiar sipas standardeve ndërkombëtare,
- c) një plan të ri llogarish që do t'i shërbente si raportimit sipas standardeve ndërkombëtare ashtu edhe raportimit sipas standardeve lokale.

Çdo vendim në lidhje me zgjidhjen e trilemës së mësipërme ishte shumë i lidhur jo vetëm me parimet kontabël e të raportimit financiar, kuadrin ligjor dhe rregullues të veprimtarisë bankare por edhe me sistemin e Librit të Madh që do të zgjidhte çdo bankë: do të ishte një sistem informacioni që do të suportonte një Plan llogarish dhe një Libër të madh apo më shumë se një Plan llogarish e një Libër të Madh.


Figura 2.2 Planet e mundshme të llogarive



Bazuar në kuadrin ligjor bankat duhet që të hartojnë një Plan të ri llogarish dhe një Libër të madh që do t'i shërbente kryesisht raportimit financiar sipas SNRF por kuadri rregullues për portofolet kryesore, për atë të huave dhe atë të investimeve ishte shumë larg standardeve ndërkombëtare dhe nuk favorizonte zbatimin e tyre. Nga ana tjetër, nuk ishte e qartë nëse Plani i llogarive për bankat, i miratuar në vitet 90-të, ishte shfuqizuar apo jo. Ndërkohë Banka e Shqiperisë nuk u shpreh as për Planin e llogarive dhe as për Librin e madh.

Kjo situatë “amullie” legislative dhe rregulluese në lidhje me Planin e llogarive dhe Librin e madh diktonte hartimin për çdo bankë të një plani llogarish dhe të një Libri të madh dyjarës. Teorikisht kjo është e mundur. Sot ka sisteme Librash të mëdhenj të mbështetur në më shumë se një plan llogarish, pra ka sisteme Librash të mëdhenj ku transaksionet që vijnë nga sistemet e tjera pasqyrohen përfundimisht në dy apo më shumë Libra të Mëdhenj si pasojë e zbatimit të dy planeve të ndryshme llogarish. Këto sisteme, të tilla SAP, Peoplesoft, etj., quhen sisteme të Planifikimit të Burimeve të Ndërmarrjes – PBN (në anglisht Enterprise Resource Planning Systems – ERP) të cilat, përveç mbajtjes së kontabilitetit financiar, bëjnë të mundur edhe mbajtjen e kontabilitetit të kostos. Por natyrisht që këto sisteme janë të shtrenjta dhe kanë një kosto operative të lartë.

Figura 2.3 Sistemi i Librit të madh dhe regjistrimet kontabël



Pavarësisht nga rrethanat dhe nga kostot e mundshme, bankat vendosën që të ruajnë Planin ekzistues të llogarive i cili garantonte raportimin financiar sipas standardeve lokale. Ndërsa raportimin financiar sipas SNRF-ve bankat vendosën që ta realizonin nëpërmjet të dhënave origjinale kontabël nga Libri i madh sipas standardeve lokale dhe/ose të dhënave të këtij libri edhe të Magazinës së të dhënave të cilat duhet të përpunoheshin me modele të pranuar nga standardet ndërkombëtare të raportimit financiar dhe kërkesave të Akordit II të Bazelit.

Kjo zgjedhje me kalimin e viteve u vërtetua se ishte një zgjedhje e drejtë, e shpejtë, pa kosto të madhe dhe iu përgjigj më së miri jo vetëm kërkesave të SNRF-ve të asaj kohe por edhe ndryshimeve apo standardeve të mëvonshme dhe po kështu kemi bindjen absolute që do t'ju shërbejë edhe ndryshimeve apo standardeve të reja në të ardhme. Kjo falë konceptit “të lirisë” mbi Librin e madh dhe Planin e llogarive që japin SNRF-të por edhe falë punës së bërë në vitet 90-të nga grupi përkatës i punës, falë asistencës së huaj si edhe falë përpjekjeve nga autoritetet përkatëse duke përfshirë edhe Këshillin Kombëtar të Kontabilitetit që arritën të hartonin dhe të miratonin një plan kontabël për bankat që i shërben sot edhe në të ardhmen nevojave të çdo lloj raportimi financiar.

3. Sfidat që na presin

A. Për bankat dhe institucionet e tjera financiare

- **Konsensusi me Autoritetet rregulluese dhe ato tatimore**

Arritja e një gjuhe të përbashket me autoritetet rregulluese dhe me autoritetet tatimore të paktën për klasifikimin, matjen dhe çregjistrimin (fshirjen) e aktiveve financiare është sfida me e madhe e bankave në vitet e ardhshme. Bankat janë të bindura që në këto kohë të turbullta të krijuara nga kriza globale financiare dhe sidomos kriza financiare e vendeve evropiane, vështirësitë për konsensus janë tepër të mëdha. Nevoja e financave publike për fonde, nevoja e BSh për të mbajtur bankat të mbikapitalizuara vështirësojnë edhe më shumë gjetjen e konsensusit.

- **Kontabiliteti i kostos**

Megjithë arritjet në kontabilitetin financiar dhe në raportimin financiar kërkesat aktuale për bankat janë shtuar edhe në drejtim të kontabilitetit të kostos. Përparësia e kontabilitetit financiar ka detyruar autoritetet rregulluese prestigjioze të kërkojnë vëmendjen e bankave dhe t'i detyrojnë ato për të organizuar kontabilitetin e kostos sipas linjave të biznesit dhe sipas produkteve gjë që do të ndihmojë në një qeverisje më të mirë të bankave dhe në uljen e kërkesave për kapital rregullator.

B. Për vendosësit e standardeve

- **Ndryshimet e vazhdueshme të SNRF-ve**

Eksperienca e deritanishme ka vërtetuar se SNRF-të janë në zhvillim në numër dhe në përmbajtje. Nga ana jonë kërkohet vëmendje dhe mundësisht pjesëmarrje në diskutimet paraprake për ndryshimet apo standardet e reja. Kjo mund të arrihet nëpërmjet tavolinave të rrumbullakta për çdo projekt-ndryshimi ose për çdo projekt-standardi. Por edhe më tej, tavolina të rrumbullakta kërkohen edhe pas miratimit nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të ndryshimeve apo standardeve të reja me qëllim përshpejtimin e kuptimit të çdo përmirësimi në SNRF.

- **Terminologjia e kontabilitetit dhe e raportimit financiar**

Në këtë 100-vjetorin e parë të shtetit shqiptar shtrohet mëse e nevojshme hartimi i një fjalori terminologjik për kontabilitetin dhe raportimin financiar me përfshirjen e një grupi të gjerë akademikësh dhe specialistësh të fushës përkatëse por edhe të gjuhësisë. Ne duhet të kujtojmë përpjekjet shumë të mëdha të rilindasve por edhe të brezave të mëvonshme për të pasur në shqip edhe termat e kësaj fushe deri aty sa edhe termi “**kontabilitet**” është shqipëruar në **llogarisi**, përpjekje që gjatë viteve të mëvonshme për arsye politike nuk u njohën apo u zhvlerësuan.

- **Rishikimi i përkthimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar**

Megjithëse është rënë dakord që përparësi ka teksti në anglisht i SNRF-ve mendoj se është bërë shumë mirë që ato janë përkthyer në shqip. Por përkthimi i SNRF-ve është bërë në një kohë të shkurtër dhe me nxitim. Tashmë që jemi më të qetë mendoj se duhet të rishikohet përkthimi i standardeve dhe për standardet e reja apo për ndryshimet në ekzistuese apo për çdo dokument tjetër të Bordit që do të jetë e nevojshme të caktohet një grup i përhershëm përkthimi i cili të sigurojë shqipërimin e unifikuar për të gjithë standardet.

KLEDIAN KODRA

SFIDAT ME TË CILAT PËRBALLEN SHOQËRITË E SIGURIMIT NË SHQIPËRI NË RAPORTIMIN FINANCIAR

Përmbajtja

HYRJE	47
I Historiku i tregut të sigurimeve	47
II Zhvillimet aktuale	47
III Historiku i raportimit financiar në fushën e sigurimeve në Shqipëri	48
IV Sfidat me të cilat përballen shoqëritë e sigurimit në raportimin financiar	49
V Ndryshimet që priten në kuadrin rregullator	49

HYRJE

Tregu i sigurimeve është një pjesë tepër e rëndësishme e sistemit financiar në Shqipëri. Në të përfshihen shoqëritë private dhe ato të zotëruara nga shteti të cilat realizojnë procesin e sigurimit të individëve apo bizneseve. Në këtë referat mundohemi të trajtojmë disa aspekte të vecanta të tregut të sigurimeve që lidhen me raportimin financiar për qëllime të përgjithshme dhe atë për qëllime të raportimit të entit rregullator. Më në detaje do të fokusohemi në një historik të shkurtër të zhvillimit të raportimit financiar të shoqërive të sigurimit, sfidat me të cilat përballen këto shoqëri në Shqipëri dhe, së fundi, çfarë pritet të sjelle e ardhmja dhe si do ndihmojnë ndryshimet në standardet e raportimit financiar në përballjen e këtyre sfidave.

I Historiku i tregut të sigurimeve

Sigurimet në Shqipëri kanë filluar mjaft vonë krahasuar me vendet e tjera të zhvilluara, dhe janë zhvilluar me karakteristikat dhe historikun e tyre. Ky historik i ka fillesat në **vitin 1944**, kur shoqëritë angleze, franceze dhe ato italiane ndihmuan në krijimin e një tradite të mirë për domosdoshmërinë e sigurimeve, me ushtrimin e aktivitetit të tyre sigurues të përqëndruar në qytetet kryesore të vendit, dhe kryesisht, në industri, ndërtim, sigurimin e aksidenteve, të jetës dhe fatkeqësive natyrore.

Në periudhën **pas Luftes se II Boterore prej vitit 1948 deri ne 1965**, filluan të shfaqen edhe forma të reja të sigurimit, si: sigurimi i detyrueshëm i banesave shtetërore, sigurimi vullnetar i pasurisë, ndërtesave dhe pasurive të paluajtshme, sigurimi vullnetar i kulturave bujqësore dhe i blegtorisë, sigurimi vullnetar i jetës nga fatkeqësitë, sigurimi i detyrueshëm i mallrave të importit, etj.

Në **vitin 1991** në Shqipëri krijohet kompania e parë e sigurimeve , “**INSIG**” SH.A. Instituti i Sigurimeve INSIG u krijua me miratimin e ligjit nga Parlamenti Shqiptar për krijimin e Institutit të Sigurimeve, duke e ndarë atë nga **Instituti i Arkave të Kursimit dhe Sigurimeve**.

II Zhvillimet aktuale

Aktualisht në tregun e sigurimeve egzistojnë **nëntë** kompani sigurimesh (Sigal Uniq Group Austria sh.a, Sigma, Interbalkan sh.a, Intersig sh.a, (grupi Viena Insurance) Atlantik sh.a, Albsig sh.a, Insig, Eurosig sh.a dhe Ansig sh.a.) të cilat operojnë në sigurimin e jo-jetës dhe

tre kompani që operojnë në sigurimin e jetës (Insig sh.a, Sicred sh.a, Sigal- Life Uniqa Group Austria Sh.a). Gjithashtu, në treg janë **gjashtë** kompani brokerimi (MAI sh.a, P&C Albania sh.a, Devon sh.a, ALL SIG sh.a, Bindi insurance, Broker sh.a, A-EJA Insurance Broker sh.a).

Për nga pikëpamja e vleres së primeve të shkruara, tregu shqiptar i sigurimeve arriti vleren e EUR 47 milione më 30 shtator 2012, nga të cilat EUR 42 milione (90%) lidhen me veprimtarinë e jo-jetës dhe pjesa e mbetur me atë të jetës. 55% e tregut lidhet me sigurimet motorrike, që do të thotë se niveli i sofistikimit dhe i penetrimit të këtij sektori është ende në nivele fillestare.

Bazuar në të dhënat zyrtare të publikuara, për 9-mujorin të parë të vitit 2012, tregu i sigurimeve duket se ka pësuar një rënie të lehtë krahasuar me periudhen paraardhëse prej 0.18% megjithëse numri i policave të shitura ka rënë me 8% për këtë periudhë.

Ndërkohe që në veprimtaritë e jo-jetës shënohet rritje në prime të shitura prej 7%, në aktivitetet e jetës kemi një rënie të konsiderueshme prej 21%.

III Historiku i raportimit financiar në fushën e sigurimeve në Shqipëri

Gjatë viteve të fundit është krijuar një bazë juridike që rregullon të drejtat dhe detyrimet ndërmjet të siguarit dhe shoqërisë siguroese, janë zgjeruar llojet dhe tipet e mbulimit të sigurimit, si dhe janë krijuar kushtet dhe mundësitë e risigurimit me shoqëri të huaja por edhe vendase si mjet i domosdoshëm i mbrojtjes së interesave të të siguarëve.

Para hyrjes në fuqi të ligjit të kontabilitetit më 2004-ën, shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri përdornin si referencë të një kuadri ligjor raportues ligjin nr. 7661, date 19.1.1993 "Për kontabilitetin" i cili kishte si referencë kryesore Planin Kontabël të Përgjithshëm duke lejuar përjashtime për fusha specifike, si p.sh. kjo e sigurimeve, ku mbivendosej ndonjë udhëzim apo urdhër i lëshuar nga enti rregullator i sigurimeve.

Aktualisht legjislacioni në fuqi që rregullon raportimin financiar në sektorin e sigurimeve përbëhet nga tri ligje dhe një numër rregulloresh. Ligjet që aplikohen janë:

1. Ligji per kontabilitetin

Organizimi i kontabilitetit bazohet ne **Ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"**. Ligji përcakton se të gjitha bankat, shoqëritë e sigurimit dhe të gjitha shoqëritë të licensuara për të kryer investime në letrat me vlere janë të detyruara të zbatojnë standardet ndërkombetare të kontabilitetit apo SNRF.

2. Ligji nr. 9572, date 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", qëllimi i të cilit është krijimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si institucioni i vetëm kompetent për licensimin e subjekteve në fushën financiare jobankare dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së këtij tregu.

3. Ligji nr. 9267, date 29.07.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime" i amenduar në 2007-en, objekt i të cilit është vendosja e parimeve dhe rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga Autoriteti, të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në këtë ligj.

Në vitin 2006 u krijuar Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF), një institucion publik i pavarur nga ekzekutivi, përgjegjes për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit financiar jobankar. Ky ent tashmë ka autoritetin për lëshimin e akteve nënligjore e rregulloreve mbi

raportimin financiar të cilat mund të krijojnë ndonjë devijim nga kuadri kontabël për shoqëritë e sigurimit i bazuar në SNK/SNRF.

Sikurse evidentohet nga sa me lart, shoqëritë e sigurimit i nënshtrohen zbatimit të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 4 – “Kontratat e Sigurimit”.

Objektivi i këtij standardi është të specifikojë raportimin financiar për kontratat e sigurimit nga çdo njësi ekonomike që lëshon kontrata të tilla. SNRF 4, publikuar në vitin 2004, solli përmirësime në kontabilitetin në fushën e sigurimeve. Ky standard konkludoi në përkufizimin e kontratës së sigurimit, dha udhëzime për ndarjen përfundimtare të komponentëve të sigurimit me atij të depozitës.

Standardi lejoi vazhdimin e politikave kontabel ekzistuese me përjashtime të veçanta si p.sh:

- provigjone për dëme të mundshme në të ardhmen nuk mund të njihen (lejohen vetëm rregullime për dëme të raportuara por të pashlyera “RBNS” dhe për ato dëme të ndodhura por të pa raportuara “IBNR”)
- testi për mjaftueshmërinë e rezervave teknike apo detyrimeve siguroese të njohura bëhet i nevojshëm
- rregullime rreth momentit të ç’rregjistrimit të detyrimit të sigurimit
- transaksionet e risigurimit nuk lejohet të kompensohen
- udhëzim mbi zhvleresimin e aktiveve të risigurimit
- shënime shpjeguese të zgjeruara që të japin informacion për përdoruesit në lidhje me riskun siguroes të marrë përsipër nga shoqëria.

IV Sfidat me të cilat përballen shoqëritë e sigurimit në raportimin financiar

Me gjithë përmirësimet që solli SNRF 4, ai nuk ndihmoi shumë në krahasueshmërinë e pasqyrave financiare të kompanive që lëshojnë kontrata sigurimi. Në mungesë të udhëzimeve të qarta për njohjen dhe matjen, janë në përdorim një varietet i gjerë i politikave kontabël apo praktikave kontabël.

Disa nga sfidat me të cilat përballen kompanitë e sigurimeve aktualisht janë::

- Rezerva e primeve të papërfituara – duke patur efekt në njohjen e primit (cilesia e të dhënave, sisteme të dobëta informative për alokimin e të ardhurës në kohë;
- Rezerva matematikore – më së shumti në kontratat e sigurimit të jetës;
- Rezerva për dëmet - të raportuara apo të ndodhura por jo të raportuara – kanë rezultuar kalkulime kreative duke u mbështetur në njohuri të kufizuara në tregjet më pak të zhvilluara, veçanërisht për IBNR (*Incurred but not reported*)- pjesërisht për shkak të mungesës së të dhënave kumulative (të dhëna të sakta mbi ecurinë e dëmeve në vite dhe vlerësimin e këtyre dëmeve – vlerësime që në masë të madhe dërgohen për kontestim deri në instancat më të larta të gjyqësorit);
- Rezerva për rifinancimin e primeve – p.sh ‘ndarja e fitimit’ të kontratës
- Rezerva për anulimet – policat e anuluar
- Kosto e shtyrë e marrjes në sigurim – a përmbushen të gjitha kriteret për njohjen e një aktivi?

Megjithatë njohja e rezervave të tilla është e lejuar (si vazhdimësi e politikave kontabël ekzistuese), nuk ka udhëzime për llogaritjen e tyre – po kështu mungon një marreveshje themelore nëse duhen njohur rezervat e skontuara apo të paskontuar.

V Ndryshimet që priten në kuadrin rregullator

Më poshtë po paraqesim një analizë të ndryshimeve që janë aktualisht në planin e ardhshëm të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Bordi ka nisur një Draft Paraprak (Exposure Draft) në lidhje me kontabilizimin e kontratave të sigurimit, ku rreket të përmiresojë dhe ndryshojë në menyrë gati radikale modelin e matjes.

Ky model i matjes e përcakton detyrimin sigurues si diferencë të vlerës së pritshme aktuale të flukseve monetare të ardhshme dalëse minus flukset monetare të ardhshme hyrëse që do të shfaqen gjatë kohës kur siguruesi përmbush kontraten e sigurimit, e rregulluar për efektin e pasigurisë për vlerën dhe kohën që këto flukse monetare të ardhshme do të realizohen (vlera aktuale e flukseve monetare të përmbushjes), si dhe për një marzh që duhet të mbetet.

Ky model pritet të aplikohet për të gjitha kontratat e sigurimit (të jetës dhe jo të jetës), megjithëse është prezantuar edhe një model i thjeshtësuar për detyrimet e momentit para ndodhjes së dëmit në rastin e kontratave afatshkurtra.

Modeli përdor qasjen me të ashtuquajturat “bloqe” ose “building blocks”. Bloqet janë së pari, flukset monetare të pritshme, më pas një normë skontimi, një rregullim/axhustim për riskun dhe së fundi një marzh i mbetur. Ky është një model korrent (që bazohet në të tashmen), kështu që flukset monetare janë të bazuara në informacione aktuale dhe janë skontuar në vlerën e tyre aktuale. Norma e skontimit reflekton karakteristikat e detyrimit.

Vlera aktuale e flukseve monetare të përmbushjes së detyrimit reflekton pozicionin neto të flukseve monetare dalëse (psh. dëmet) dhe hyrese (primet). Megjithëse “bloqet” llogariten si komponente tëvecante, paraqitet vetëm një detyrim – marzhet nuk paraqiten veçmas.

Një tjetër pikë për t’u përmendur është që Drafti Paraprak (ED) thekson se detyrimi për një kontratë sigurimi (duke përfshirë metodën short-cut që përdoret gjerësisht të primit të pafituar) në monedhë të huaj (primet në EUR psh) do të trajtohet si një zë monetar sipas IAS 21. Kjo shmang disa nga mospërputhjet që krijoheshin me IFRS 4, sipas të cilës balancat e primeve të pafituara trajtoheshin si zëra jo monetar.

Ndikimi i ndryshimeve në aftësinë paguese të shoqerive të sigurimit – SOLVENCY II project

Rendesia ekonomike dhe sociale e sigurimit është e tillë që nderhyrja nga autoritetet publike, në formën e mbikeqyrjes së kujdesshme, është pranuar tashmë në përgjithësi që është e nevojshme. Jo vetëm që siguruesit ofrojnë mbrojtje kunder ngjarjeve të ardhshme që mund të rezultojnë në humbje, por ata gjithashtu kanalizojnë kursimet në tregjet financiare dhe në ekonomine reale. Po kështu në raste të problemeve me moskthimin e kredive të bankave mund të kemi një transferim të riskut kreditor që mbajnë bankat të shoqerive të sigurimit. Nderhyrja nga autoritetet publike ka tentuar të përqendrohet në prezantimin e masave që synojnë të garantojnë aftësinë paguese të shoqerive të sigurimit, apo për të minimizuar humbjet e shkaktuara nga falimentimi.

Efekti që pritet të sjellë projekti SOLVENCY II është prezantimi i një regjimi të ri ekonomik të bazuar në riskun e aftësisë paguese si mjeti më efektiv dhe efikas për të përmbushur objektivat e përgjithshme të projektit.

Ky projekt vendos theks më të fortë në menaxhimin e riskut dhe kontrolleve të brendshme të shoqerive. Përgjegjësia për qendrueshmerinë financiare të siguruesit vendoset në nivelin menaxherial, aty ku edhe i takon. Siguruesit i jepet më shumë liri - dmth nga ata do të kerkohet të përmbushin parimet dhe jo të nënshtrohen rregullave arbitrare shumë të detajuara. Kerkesat rregullatore dhe praktika në industri do të përafrohet dhe siguruesit do të

shperblehen per implementimin e sistemit te menaxhimit te rrezikut dhe te kapitalit qe i pershtatet me se miri nevojave te tyre dhe profilit te rrezikut te pergjithshem.

Ne pergjithesi, perfitime te konsiderueshme priten nga projekti SOLVENCY II dhe ndikimi per te gjitha palet e interesuara eshte pozitiv.

Industria: Perfituesit e drejtperdrejte te SOLVENCY II do te jene siguruesit. Pervec promovimit te menaxhimit te riskut, parafrimit te kerkesave mbikeqyrese me praktikat e tregut dhe shperblimit te kompanive te mire-menaxhuara, regjimi i ri do te ngreje gjithashtu nje fushe loje te vertete me te drejta te barabarta dhe do te kontribuojne ne integrimin e metejsheem te tregut te sigurimeve ne BE.

Mbajtesit e policave: Perfituesit kryesore te terthorte te SOLVENCY II do te jene mbajtesit e policave. Regjimi i ri do te siguroje nje nivel te njetrajtshem dhe te zgjeruar te mbrojtjes se polices ne te gjitha BE-ne, duke zvogeluar mundesite qe mbajtesit e policave te humbasin si rezultat i veshtiresive financiare qe perjetojne siguruesit. Prezantimi i nje qasjeje ekonomike te bazuar ne rrezik do tu jape mbajtesve te policave besim me te madh ne produktet e ofruara nga siguruesit, pasi SOLVENCY II do te promovojte menaxhim me te mire te riskut, çmime te qendrueshme dhe mbikeqyrje te perforcuar. Se fundi, SOLVENCY II do te rrise konkurrencen, duke bere presion per renien e çmimeve te larta te sigurimeve, dhe do te rrise mundesine e zgjedhjes duke perkrahur produktet inovatore.

Ekonomia si nje e tere: Pervec rritjes se konkurrences nderkombetare te tregut te sigurimit, rreshtimi i kerkesave rregullative me realitetin ekonomik do te siguroje nje shperndarje me te mire te kapitalit ne nivel kompanie, ne nivel industri, dhe ne kuader te ekonomise ne BE.